

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njesia Org. Org.-Jedinitca Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot.No.	05-5127
Nr. i faqevë Br. stranica No. pages	- 61 -
Data Datum Date	25, 09, 2019
Prishtinë / a	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministra e Shëndetësisë/Ministarstva Zdravstva/Ministry of Health*  
*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Ured Generalnog Sekretara/Office of General Secretary*

**Prishtinë**  
**24/09/2019**

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, duke marrë parasysh nenin 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe 6) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22/03/2011), dhe në pajtim me nenin 5 (paragrafi 5.4. c) të Rregullores 2001/19 për Degën e Ekzekutivit, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Ministrit të shëndetësisë me Nr. 43/2019 të dt. 20/09/2019 për miratimin e Listës së barnave esenciale e cila mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës, nxjerr:

### Qarkore Informative Nr. 03/2019

**Për:**

- *Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës;*
- *Inspektoratin shëndetësor;*
- *Inspektoratin farmaceutik;*
- *Fondin e Sigurimeve Shëndetësore;*
- *Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;*
- *Institutin Kombëtar për Shëndetin Publik të Kosovës;*
- *Qendrën Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut të Kosovës;*
- *Divizionin Farmaceutik në Msh;*
- *Divizionit e Prokurimit në Msh;*
- *Divizionin e Kujdesit Parësor;*
- *Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale*
- *Drejtoritë e qendrave kryesore të Mjekësisë Familjare*

**Cc:** Z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë  
 Bordin Drejtues të SHSKUK-së;  
 Bordin Drejtues të FSSH-së;

**Qëllimi:** Zbatimi i Listës së Barnave Esenciale ( pjesa e produkteve mjekësore) e cila mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës;

**Obligohen:** Të gjitha Institucionet shëndetësore të marrin të gjitha masat e duhura për realizimin/zbatimin e Listës esenciale;

Pjesë e kësaj Qarkoreje është Shtojca 1 me të cilin është përcaktuar Lista e Barnave Esenciale (pjesa e produkteve mjekësore) e cila mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës;

**Dr. Naim Bardiqi**  
Sekretar i Përgjithshëm, MSH



**Shtojca 1:** Lista e barnave esenciale (pjesa e produkteve mjekësore) e cila mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës;



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësi Org. Org. Jedinica Org. Unit	01
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No	65-5046
Nr. J. faqevë Br. stranica No. pages	203
Data: Datum: Date:	20/09/2019
Prishtinë / e	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

*Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health*  
*Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister*

**Nr. 43/2019**  
**Datë: 20.09.2019**

Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë,  
Në mbështetje të nenit 145(pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;  
Duke marrë parasysh nenet 10 dhe 11 Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7 / 01 Mars 2019), Duke u bazuar në Nenin 8(paragraf 1.4) dhe Shtojcën 9 paragrafi ii të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive(22.03.2011), Neni 3, paragrafi 1.19 i Ligji Nr.04/L-125 Për Shëndetësi, nxjerr:

**V E N D I M**

- I. Miratohet Lista e Barnave Esenciale (pjesa e produkteve mjekësore) e cila mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- II. Anulohet Lista e barnave Esenciale e vitit 2013 sa i përket produkteve mjekësore;
- III. Mbetet në fuqi lista për material harxhues, pajisje mjekësore, material diagnostik dhe asistiv;
- IV. Pjesë e këtij vendimi është Shtojca I me të cilin është përcaktuar Lista e Barnave Esenciale (pjesa e produkteve mjekësore) e cila mbulohet nga buxheti i Republikës së Kosovës;
- V. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë t'i njoftojë të gjitha institucionet për zbatimin e listës së barnave esenciale;
- VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Uran Ismaili**  
**Ministër i Shëndetësisë**

*Vendimi i dërgohet:*

- *Zëvendësministrave të MSH;*
- *Sekretarit të Përgjithshëm MSh;*
- *Inspektoratin shëndetësor;*
- *Fondit të sigurimeve shëndetësore;*
- *SHSKUK;*
- *AKPPM;*
- *IKSHPK;*
- *QKTGJK;*
- *Divizionit farmaceutik;*
- *Divizionit të prokurimit;*
- *Divizionit të kujdesit parësor;*
- *Departamentit ligjor;*
- *Departamentit të Administratës së MSH-së,*
- *Arkivit të MSH.*





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org Org. Jedinica Org. Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	05-50.30
Nr. ffaqeve Br. stranica No. pages	-04-
Data Datum Date	20.09.2019
Prishtinë / a	

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH  
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Ured Generalnog Sekretara/ Office of the Secretary General

**LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP**

REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	Z Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dr Naim Bardiqi, Kryesues i komitetit teknik për përpilimin e Listës së produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim për aprovim të Listës ë barnave esenciale.
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	116
Lokacioni: Kucni: Extension:	MSH
Data: Datum: Date:	19/09/2019
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION	<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL	<input checked="" type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE	<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS	<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS	<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION	<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED	<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED	<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN	<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION	<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE	

I nderuari z. Ministër,

Komiteti teknik për përpilimin e Listës Esenciale të produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese (LBE), sipas propozimeve të institucioneve shëndetësore, i themeluar me vendimin tuaj nr. 37/18, 05-5259, datë 6 gusht 2018, pas një punë intenzive, profesionale dhe transparente ka hartur Listën e re të Barnave esenciale, të cilën e ka miratuar me konsensus të plotë në takimin e tij të 20-të, të mbajtur me datë 18 shtator 2019.

Finalizimi dhe miratimi i kësaj liste nga Komiteti teknik është arritur pas një pune më shumë se një vjeçare gjatë të cilës anëtarët e Komitetit teknik, të mbështetur nga Sekretaria teknike e Komitetit, kanë shqyrtuar qindra propozime për përfshirje të barnave, materialeve shpenzuese dhe pajisjeve në Listën e produkteve Esenciale të dhëna nga: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK: QKUK dhe spitalet e përgjithshme); Kujdesi Parësor Shëndetësor; subjektet (kompanitë) farmaceutike; shoqatat profesionale; shoqatat që përfaqësojnë kategori të pacientëve me sëmundje të ndryshme si dhe propozime individuale të profesionistëve shëndetësor, qytetarëve apo edhe vet pacientëve, me qëllimin që Lista e re e Barnave Esenciale të jetë sa më gjithëpërfshirëse që reflekton nevojat kryesore të popullatës për barna cilësore, të sigurta dhe kost-efektive.

Komiteti teknik ka vendosur që në Listën e Barnave Esenciale të përfshihen: Propozimet për barna të reja për të gjitha kategoritë e patologjive; propozimet për materiale shpenzuese; propozimet për sëmundje të rralla dhe sklerozën multiple; propozimet për dializë; propozimet për insulina; propozimet për citostatikë; propozimet për barnat që janë pjesë e Udhërrëfyesve klinikë, të miratuar me vendim të Ministrit të Shëndetësisë dhe propozime për terapi të reja efektive të bazuara në dëshmi shkencore.

Pas shqyrtimit të aplikacioneve nga Komiteti teknik, propozimet e dhëna janë agreguar në Listën e Barnave Esenciale, sipas modelit të OBSH-së, edicioni i 21-të, duke u përmbledhur në një listë të vetme brenda të cilës janë përfshirë:

- Barnat nga Lista në fuqi e OBSH-së;
- Produkte nga Lista e Barnave Esenciale në fuqi (2012);
- Propozimet e reja nga të gjitha palët për përfshirje në këtë listë me arsyetimet përkatëse profesionale.

Komiteti, për t'i përfshirë në listë propozimet ka marrë në konsideratë elementet kritike si:

- Rëndësinë e barit për shëndetin publik
- Efikasitetin klinik
- Sigurinë e barit të propozuar
- Kosto-efektivitetin, etj.

Komiteti ka punuar që LBE, t'i përgjigjet buxhetit të ndarë për barna dhe material shpenzues në kuadër të buxhetit të shëndetësisë.

Lista që ju paraqesim për miratim paraqet Listën bazike të Barnave Esenciale që paraqet një listë të nevojave minimale të barnave bazike kryesore të sistemit shëndetësor, efikase, të sigurta dhe kost-efektive, të përzgjedhura bazuar në rëndësisë aktuale të shëndetit publik si dhe kosto efektivitetin sipas metodologjisë së OBSH dhe, gjithashtu edhe Listën plotësuese apo komplementare të Barnave Esenciale, e cila përfshin barna të cilat konsiderohen se i plotësojnë

kriteret për të qenë esenciale, mirëpo në bazë të prioritizimit kanë mbetur në këtë kategori duke u bazuar në buxhetin aktual të dedikuar për këtë qëllim. Furnizimi me këto produkte mund të bëhet nëse do të ketë ndryshime –shtëm të buxhetit apo nëse barnat bazike mund të sigurohen me çmime më të lira, me ç'rast pjesa e liruar e buxhetit mund të dedikohet për ndonjë nga këto barna.

Lista e Barnave ka qenë pjesë e diskutimeve publike sipas Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës për dokumentet strategjike, duke marrë gjithashtu edhe opinionin e Grupit të MSH-së për kostim të politikave të reja si dhe opinionet e Departamentit Ligjor dhe të Departamentit të Integritimeve Evropiane të MSH-së.

Krahasuar me Listën e Barnave Esenciale të vitit 2012, LBE e re ka sjellë një varg përparësish. Lista e re ka brenda vetes rreth 100 barna të reja dhe përparësi të tjera krahasuar me listën në fuqi, pasi që, ndër të tjera bën kalimin në formatin e plotë të OBSH-së; eliminon interpretimet e gabuara të specifikacioneve që në të kaluarën kanë sjellë probleme të shumta në kontraktim; ridizajnon listën e antibiotikëve sipas klasifikimit të ri të OBSH – AWARE (Access – Éatch and Reserve); plotëson listën me barna për përdorim në Onkologji, Hematologji e fusha të tjera; përfshin barna për sëmundjet e rralla si dhe shumë risi, të cilët do t'i kontribuojnë rregullimit të sektorit farmaceutik dhe një furnizimi më të qëndrueshëm të sektorit shëndetësor publik.

Gjatë hartimit të Listës së Barnave Esenciale, Komiteti teknik ka pasur mbështetjen e ekspertëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë nga Zyra Qendrore e OBSH-së në Gjenevë, Zyra Rajonale për Evropë dhe Zyra e OBSH-së në Prishtinë.

Për të parandaluar çfarë do forme apo manifestimit të konfliktit eventual të interesit të anëtarëve të Komitetit, që në takimin inaugurues të tij, anëtarët e Komitetit janë vënë në dijeni për obligimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, përmes nënshkrimit të Deklaratës mbi Konfliktin e Interesit.

Krejt procesi është shoqëruar me një transparencë, duke i dhënë mundësi shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara që ta monitorojnë nga afër procesin, duke marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet dhe punëtoritë e Komitetit, ndërkohë që, publikut i janë vënë në dispozicion, përmes ueb faqes së MSH-së dhe formave të tjera të komunikimit, dokumente të rëndësishme dhe informacione me kohë për ecurinë e procesit.

Furnizimi i sigurt dhe i qëndrueshëm me barna dhe pajisje medicinale esenciale është një nga çështjet e rëndësishme të shërbimeve cilësore shëndetësore në institucionet shëndetësore publike.

Revidimi i LBE, bashkë me miratimin e UA për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve medicinale, paraqesin në fakt thelbin e zhvillimit të reformës në sektorin farmaceutik në Kosovë. Revidimi i Listës së Barnave Esenciale është bërë me përkushtim maksimal, përgjegjësi, analizë të zhvillimeve në industrinë farmaceutike, transparencë dhe llogaridhënie. Synimi është i qartë

që Lista e Barnave Esenciale të përmbush nevojat prioritare të kujdesit shëndetësor të popullatës me një kosto të përballueshme.

Prandaj, duke miratuar Listën e Barnave Esenciale këtë listë, MSh i jep një shtytje të madhe procesit të reformave në sektorin farmaceutik dhe në krejt sistemin shëndetësor në përgjithësi, ndërsa si politikë e re, revidimi i LBE-së paraqet një aktivitet të rëndësishëm në kuadër të angazhimeve për zbatimin e objektivit kryesor të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore dhe Planit të Veprimit (2018-2021) – ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të popullatës.

Pas miratimit të Listës së barnave Esenciale, Komiteti do të vazhdojë punën në finalizimin e draft-listës së pajisjeve esenciale (ku përfshihet edhe materiali shpenzues medicinal), Listës së produkteve diagnostike dhe Listës së pajisjeve Asistive esenciale.

Me respekt,

Bashkëngjitur:

Lista e Barnave Esenciale





**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria - Vlada- Government**

**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health**

# Lista e Barnave Esenciale

Botimi i katërt

Prishtinë, shtator 2019

## FJALA E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË



Kemi ardhur në fund të një procesi të gjatë, të mundimshëm, por jashtëzakonisht të rëndësishëm për sektorin e shëndetësisë, për profesionistët shëndetësorë, dhe në veçanti për pacientët tanë.

Pas një pune intenzive, profesionale dhe transparente, para jush keni Listën e re të Barnave Esenciale të Kosovës të hartuar nga Komiteti për revidimin e Listës së Barnave Esenciale në Kosovë.

Në fillim të mandatit tim si ministër kur e kam kuptuar se kjo listë nuk është përditësuar që nga viti 2012 – e kam vënë menjëherë si prioritet revidimin e saj, i bindur se mungesa e përditësimit të një dokumenti kaq të rëndësishëm është një barrë e rëndë për sektorin e shëndetësisë, shëndetin, ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë.

Për afro 7 vjet – qytetarët tanë janë ballafaquar me mungesë të barnave adekuate për trajtimin e sëmundjeve të tyre; profesionistët shëndetësorë nuk kanë mundur të përshkruajnë barnat më të reja për pacientët; si dhe Ministria e Shëndetësisë, shteti jonë, ka vuajtur nga mungesa e kësaj liste që ka rënduar të gjithë popullatën.

Sot – me aprovimin e kësaj liste – ne po u dalim në ballë përgjegjësive tona institucionale dhe pas një kohe të gjatë po krijojmë një mburojë financiare të mirëfilltë për popullatën tonë.

Lista e re e Barnave Esenciale është produkt i punës profesionale dhe ekspertizës ndërkombëtare e vendore, profesionistëve shëndetësorë, pacientëve dhe shoqatave të tyre. Për herë të parë, hartimi i Listës është bërë me ndihmën dhe nën monitorimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, shoqërisë civile dhe Agjencisë kundër Korrupsionit.

Kjo Listë përveç që do të sigurojë barnat më të mira për popullin tonë, krijon një mburojë financiare për ta dhe ndalë varfërimin e tyre që ka ndodhur deri më sot.

Finalizimi dhe miratimi i Listës nga Komiteti teknik është arritur pas një pune më shumë se një vjeçare gjatë të cilës anëtarët e Komitetit kanë shqyrtuar qindra propozime nga profesionistët e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor, shoqatat që përfaqësojnë kategori të pacientëve me sëmundje të ndryshme si dhe vet pacientët.

Synimi ynë si politikë-bërës dhe i Komitetit si menaxhues i procesit ka qenë që Lista e re e Barnave Esenciale të jetë sa më gjithëpërfshirëse dhe popullatës sonë t'i mundësojë që nga tash e tutje, të përdor barna cilësore, të sigurta dhe kost-efektive.

Kjo listë, e cila ka mbi 100 produkte të reja, është hartuar duke marrë në konsideratë edhe analizën e zhvillimeve në industrinë farmaceutike, transparencën dhe llogaridhënien. Për më tepër, lista do

të ndihmojë që të eliminohen interpretimet e gabuara të specifikimeve që në të kaluarën kanë sjellë probleme të shumta në procesin e prokurimit.

Për herë të parë, përmes nënshkrimit të Deklaratës mbi Konfliktin e Interesit, është parandaluar çfarëdo forme apo manifestim i konfliktit eventual të interesit nga anëtarët e Komitetit.

Revidimi i LBE, bashkë me miratimin e UA për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve medicinale, paraqesin në fakt thelbin e zhvillimit të reformës në sektorin farmaceutik në Kosovë.

Me miratimin e kësaj liste, ne po i japim një dimension të ri reformave në sektorin farmaceutik dhe në krejt sistemin shëndetësor në përgjithësi, në funksion të zbatimit të misionit kryesor të Ministrisë së Shëndetësisë që është – ruajtja dhe përparimi i shëndetit të popullatës.

Me miratimin e Listës Esenciale-komponentin e barnave, Komiteti do të vazhdoj punën e tij në hartimin listave të veçanta për pajisje esenciale ku hyjnë edhe materialet shpenzuese; listën e produkteve diagnostike dhe listën e pajisjeve asistive, me qëllim që të kemi një përgjigje adekuate për të gjitha llojet e produkteve që përdoren në mjekësi.

Në fund falënderoj Komitetin teknik dhe Zyrën Qendrore të OBSH-së në Gjenevë dhe atë në Prishtinë, për përkrahjen në hartimin e kësaj liste e cila tash e tutje do të përditësohet sipas praktikave që i ka kjo organizatë.

Faleminderit!

**Uran Ismaili,**

**Ministër i Shëndetësisë**



## **Përmbajtja**

FJALA E MINISTRIT TË SHËNDETËSISË.....	2
Përmbajtja .....	4
Përmbledhja ekzekutive .....	5
Përbërja e Komitetit teknik .....	6
Sekretaria .....	7
Përfaqësuesit nga OBSH.....	7
Deklarata e Konfliktit të Interesit .....	8
Shkurtesat e përdorura .....	9
Hyrje .....	11
Objektivat.....	13
Aprovimi i vendimit.....	13
Sesioni i hapur.....	14
Çështjet e përgjithshme.....	15
Përafrimi i Listës së Barnave Esenciale dhe udhëzimeve të MSH.....	15
Formati i ri i listës.....	15
Rritja e mundësive për përballimin e barnave me çmim të lartë .....	15
Propozimi për listën diagnostike dhe listat e tjera .....	20
Përmbledhje .....	21
Drafti parafinal.....	21
Diskutimi publik .....	24
Aprovimi i listës.....	24
Përparësitë me listën e re të barnave esenciale .....	25
Kronologjia sipas grupeve të produkteve dhe mbi 100 barna të shtuara .....	26
Konsultimet publike dhe transparenca.....	27
Tabelat.....	29

## **Përmbledhja ekzekutive**

Komiteti teknik për përpilimin e Listës Esenciale të produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese (LBE), sipas propozimeve të institucioneve shëndetësore, i themeluar me vendim të Ministrisë të Shëndetësisë më 6 gusht 2018, në periudhën 13 gusht 2018-21 mars 2019 ka shqyrtuar qindra propozime për përfshirje të barnave, materialeve shpenzuese dhe pajisjeve në Listën e produkteve Esenciale të dhëna nga: Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK: QKUK dhe spitalet e përgjithshme), subjektet (kompanitë) farmaceutike; shoqatat profesionale, shoqatat që përfaqësojnë kategori të pacientëve me sëmundje të ndryshme si dhe propozime individuale të profesionistëve shëndetësor, qytetarëve apo edhe vet pacientëve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve nga Komiteti teknik, pasi të njëjtat paraprakisht janë pranuar dhe përpunuar nga Sekretaria e Komitetit, propozimet e dhëna janë agreguar në Listën e Barnave Esenciale, sipas modelit të OBSH-së, edicioni i 21-të, duke u përmbledhur në një listë të vetme brenda të cilës janë përfshirë:

- Barnat nga Lista në fuqi e OBSH-së;
- Produkte nga Lista e Barnave Esenciale në fuqi (2012);
- Propozimet e reja nga të gjitha palët për përfshirje në këtë listë me arsyetimet përkatëse profesionale.

Komiteti, për t'i përfshirë në listë propozimet ka marrë në konsideratë elementet kritike si:

- Rëndësinë e barit për shëndetin publik
- Efikasitetin klinik
- Sigurinë e barit të propozuar
- Kosto-efektivitetin, etj.

Komiteti ka vendosur që në Listën e Barnave Esenciale të përfshihen: Propozimet për barna të reja për të gjitha kategoritë e patologjive; propozimet për materiale shpenzuese; propozimet për sëmundje të rralla dhe sklerozën multiple; propozimet për dializë; propozimet për insulina; propozimet për citostatikë; propozimet për barnat që janë pjesë e Udhërrëfyesve klinikë, të miratuar me vendim të Ministrisë të Shëndetësisë etj., dhe të cilat do të grupohen si vijon:

1. Lista e Barnave Esenciale
2. Lista e pajisjeve esenciale (ku përfshihet edhe materiali shpenzues medicinal)
3. Lista e produkteve diagnostike
4. Lista e pajisjeve asistive esenciale

Komiteti ka punuar që LBE, t'i përgjigjet buxhetit të ndarë për barna dhe material shpenzues në kuadër të buxhetit të shëndetësisë.

## **Lista e pjesëmarrësve**

### **Përbërja e Komitetit teknik**

Dr. Naim Bardiqi, MSH-Kryesues  
Mr. Ph. Fatbardha Murtezi, MSH, anëtar  
Dr. Albana Sahiti-Morina, anëtar  
Mr. Ph. Hilmi Shala, SP Gjakovë, anëtar  
Dr. Gazmend Spahiu, QKUK, anëtar  
Dr. Agreta Gecaj-Gashi, QKUK, anëtar  
Dr. Basri Lenjani, QKUK, anëtar  
Dr. Tefik Bekteshi, QKUK, anëtar  
Dr. Adem Gërbolar, QKUK, anëtar  
Dr. Leandrit Bejtullahu, QKUK, anëtar  
Dr. Hajdin Thaçi, QKUK, anëtar  
Dr. Adem Miftari, QKUK, anëtar  
Dr. Agron Bytyqi, QKUK, anëtar  
Dr. Armend Kërveshi, QKUK, anëtar  
Dr. Frederik Çuperjani, QKUK, anëtar  
Dr. Luan Jaha, QKUK, anëtar  
Dr. Merkur Dobroshti, QKUK, anëtar  
Dr. Abdullah Shaqiri, QKUK, anëtar  
Dr. Sabit Mehmeti, QKUK, anëtar  
Dr. Aida Polloshka, QKUK, anëtar  
Dr. Jehona Ismaili, QKUK, anëtar  
Dr. Venera Hasangjekaj, QKUK, anëtar  
Dr. Merita Emiri, QKUK, anëtar  
Dr. Albina Ponosheci-Biçaku, QKUK, anëtar  
Dr. Shaban Mecinaj, QKUK, anëtar  
Dr. Virgjina Hasbata, QKUK, anëtar  
Dr. Teuta Kamberi-Krasniqi, QKUK, anëtar  
Dr. Fakir Spahiu, QKUK, anëtar  
Dr. Sadik Kelmendi, QKUK, anëtar  
Dr. Bujar Gjickolli, QKUK, anëtar  
Dr. Shemsedin Sadiku, QKUK, anëtar  
Dr. Ekrem Hyseni, QKUK, anëtar  
Dr. Ilir Kurtishi, QKUK, anëtar  
Dr. Elton Bahiri, QKUK, anëtar  
Dr. Edmond Komoni, QKUK, anëtar  
Dr. Valon Krasniqi, QKUK, anëtar

Mr. Ph. Granita Selimaj, AKPPM, anëtar  
Dr. Ibrahim Rudhani, QKUK, anëtar  
Mr. Ph. Amir Keka, FSSH, anëtar  
Dr. Isme Humolli, IKSHKP, anëtar  
Dr. Lul Raka, IKSHKP, anëtar  
Dr. Adnan Biçku, OMK, anëtar  
Dr. Ph. Arianit Jakupi, OFK, anëtar  
Z. Xhemajl Dugolli, OIK, anëtar  
Dr. Lumbardh Bytyqi, PRAK, anëtar  
Dr. Rukije Mehmeti, QKUK, anëtar  
Dr. Milazim Gjocaj, Departamenti i Shëndetësisë në Burgje

### **Sekretaria**

Dr. Faik Hoti, Ministria e Shëndetësisë  
Mr.Ph. Amir Keka, Fondi i Sigurimit Shëndetësor  
Mr. Ph. Fatbardha Murtezi, Ministria e Shëndetësisë  
Znj. Minire Kazazi, Ministria e Shëndetësisë  
Z. Lulzim Uka, Ministria e Shëndetësisë

### **Përfaqësuesit nga OBSH**

Nicola Magrini – OBSH, Zyra Qendrore, Gjenevë  
Lorenzo Moja - OBSH, Zyra Qendrore, Gjenevë  
Hanne Bak Pedersen – OBSH, Zyra Rajonale për Europë  
Jane Robertson – OBSH, Zyra Rajonale për Europë  
Guillaume Dedet – OBSH, Zyra Rajonale për Europë

### **Falënderime**

Dr. Ardita Tahirukaj – Zyra e OBSH në Prishtinë

### **Ekipi redaktues [Botimi i katërtë]**

Arianit Jakupi  
Valdet Hashani  
Faik Hoti  
Lulzim Uka  
Amir Keka

## **Deklarata e Konfliktit të Interesit**

Sikurse në fusha të tjera, edhe në shëndetësi konflikti i interesit ekziston si formë e ndërveprimit njerëzor, qoftë në nivel individual apo edhe institucional. Me qëllim të parandalimit të ndonjë manifestimi apo ndërveprimit të tillë, gjatë procesit të përpilimit të Listës së Barnave Esenciale, për të shmangur situatat që ndonjëri nga anëtarët e Komitetit të gjendet para një konflikti të mundshëm të interesit, ata janë vënë në dijeni për obligimet dhe detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, përmes nënshkrimit të Deklaratës mbi konfliktin e interesit.

Përmes nënshkrimit të Deklaratës mbi konfliktin e interesit, anëtarët e Komitetit teknik kanë deklaruar se i njohin ndalimet e përcaktuara me këtë ligj dhe se marrin zotimin se gjatë procesit të përpilimit të Listës së Barnave Esenciale, në rast të shfaqjes apo paraqitjes së ndonjë situatë të mundshme të konfliktit të interesit, do të deklarojnë dhe do të marrin masa për ta evituar atë, sipas detyrimeve nga neni 6, 8 dhe 17 i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike.

Me qëllim të sqarimit të plotë të këtyre detyrimeve dhe monitorimit të krejt procesit të revidimit të LBE, me ftesë të Ministrisë së Shëndetësisë, në takim inaugurues të Komitetit teknik për përpilimin e LBE, ka marrë pjesë edhe kryetari i Agjencionit Kosovar kundër Korrupsionit (AKK), z. Shaip Havolli.

Anëtarët e Komitetit, pasi kanë lexuar dhe analizuar përgjegjësitë nga Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike dhe Deklaratën e konfliktit të interesit, e kanë nënshkruar atë dhe deponuar në Sekretarinë e Komitetit teknik të LBE.

Disa anëtarë të Komitetit, gjithashtu, duke e ndjerë veten në konflikt të mundshëm interesi, janë tërhequr me kërkesë të tyre nga Komiteti që në fillim të punës së tij, në përputhje me detyrimet që dalin nga ligji.



## Shkurtesat e përdorura

MSH	Ministria e Shëndetësisë
FSSH	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore
SHSKUK	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
IKSHKP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
KTSH	Kujdesi Tretësor Shëndetësor
KDSH	Kujdesi Dytësor Shëndetësor
SP	Spitali i Përgjithshëm (Rajonal)
KPSH	Kujdesi Parësor Shëndetësor
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra Mjekësisë Familjare
AMF	Ambulanca e Mjekësisë Familjare
OMK	Oda e Mjekëve të Kosovës
OFK	Oda e Farmacistëve të Kosovës
OIK	Oda e Infermierëve të Kosovës
DF	Divizioni i Farmacisë
LBE	Lista e Barnave Esenciale
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
AKK	Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit
PRAK	Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë
KDI	Instituti i Kosovës për Demokraci

## **Sqarime\***

**LISTA BAZIKE E BARNAVE ESENCIALE** paraqet një listë të nevojave minimale të barnave bazike kryesore të sistemit shëndetësor, efikase, të sigurt dhe kost-efektive. Kushtet e përzgjedhjes së barnave – prioritizimi është bazuar në rëndësisë aktuale të shëndetit publik si dhe kosto efektivitetin sipas metodologjisë së OBSH.

**LISTA PLOTËSUESE APO KOMPLEMENTARE E BARNAVE ESENCIALE** paraqet listën e cila përfshin barna të cilat konsiderohen se i plotësojnë kriteret për të qenë esenciale, mirëpo në bazë të prioritizimit kanë mbetur në këtë kategori duke u bazuar në buxhetin aktual të dedikuar për këtë qëllim. Furnizimi me këto produkte mund të bëhet nëse do të ketë ndryshime – shtim të buxhetit apo nëse barnat bazike mund të sigurohen me çmime më të lira dhe në atë rast, pjesa e liruar e buxhetit mund të dedikohet për ndonjë nga këto barna.

**SIMBOLI I KUTISË KATRORE** (□) ka për qëllim kryesisht të tregojë performancë të ngjashme klinike brenda një klase farmakologjike. Në rastet kur ka kuti katrore furnizimi mund të bëhet me cilindo produkt brenda asaj kategorie farmakologjike në harmoni me procedurat e parapara për këtë qëllim.

- Në tabelën 1 mund të gjenden të dhëna shtesë lidhur me restriksionet në moshë dhe peshë;
- Në tabelën 2 mund të gjenden lista e formave të dozimit;

Definicione shtesë lidhur me këto terme dhe kërkesat e kualitetit mund të gjenden në formularë të ndryshëm dhe farmakope internacionale.

**SIMBOLI “a”** indikon se ka kufizim në moshë apo peshë për përdorimin e atij produkti, detajet mund të gjeni në tabelën 1.

**FORMAT FARMACEUTIKE DHE FORMAT E DOZIMIT** – në rastet kur janë forma të ngjashme si tabletë, film tabletë, kapsulë etj. ka të bëjë me forma të ngjashme apo format e forta farmaceutike orale. Apo te format e tretësirave, ku ka ngjashmëri shpesh mund të jetë likuid etj ato janë të krahasueshme pra të ngjashme. E njëjta vlen për injeksionet që vlen për format parenterale duke u bazuar në ngjashmëri të tillë.

\*Sqarimet janë bazuar sipas formatit të listës model të OBSH

## Hyrje

Furnizimi i sigurt dhe i qëndrueshëm me barna dhe pajisje medicinale esenciale është një nga çështjet e rëndësishme të shërbimeve cilësore shëndetësore në institucionet shëndetësore publike. Ky furnizim bëhet duke u bazuar në listën e aprovuar verzioni i fundit i cili është në fuqi që nga viti 2012.

Ministria e Shëndetësisë, në bazë të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi është autoritet kompetent për hartimin e Listës së Barnave Esenciale (LBE) në bazë të nenit 99 të ligjit:

*“Paragrafi 2. Lista e barnave dhe materialeve shpenzues do të definohet dhe hyjë në fuqi vetëm pasi që të vlerësohet ndikimi i saj fiskal dhe pasi që të jenë alokuar mjetet financiare brenda alokimit buxhetor (pas kalkulimit të të hyrave nga bashkë-pagesat)”.*

Në Ligjin për Shëndetësi, gjithashtu, është definuar edhe mënyra e përpilimit të listës:

*“Lista e formave dhe llojeve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor që mbulohen nga Qeveria dhe nga bashkë-pagesat 3 (përfshirë Listën e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese), e cila përpilohet nga Komiteti teknik i emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Lista mund të modifikohet sipas nevojës në bazë të vlerësimit të Ministrisë”.*

Sipas të dhënave zyrtare, verzioni i fundit i aprovuar i LBE ka qenë që nga viti 2012 pavarësisht se Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) rekomandon revidimin e LBE çdo 2-3 vjet.

Mirëpo pasi ky proces është përcjellë në të kaluarën me debate publike, shkrime në media, akuza dhe kundër-akuza se cilat produkte duhet të jenë në listë, apo edhe se disa produkte që ndodhen në listë nuk duhet të jenë më tej aty për shkak se nuk janë kërkuar nga institucionet shëndetësore, pastaj fakti se disa procese gjyqësore janë ngritur rreth vendosjes së produkteve të caktuara në listë dhe në fund është bërë edhe kontraktimi i këtyre produkteve me çmime abuzuese, Ministri Uran Ismaili ka kërkuar nga Zyra e OBSh në Prishtinë që të ndihmojë Ministrinë e Shëndetësisë në këtë procesin e revidimit të LBE me ekspertët e kësaj organizate, në mënyrë që verzioni i radhës i listës të hartohet duke u bazuar në metodologjinë, standardet dhe praktikat më të mira të definuara dhe zbatuara nga OBSh.

Asistenca fillestare e kërkuar nga OBSh dhe ekspertët e saj për Komitetin teknik ka konsistuar në:

- Përcaktimin e kriterëve;
- Definimin e termave të referencës për anëtarët e Komitetit;
- Definimin dhe shmangien e konfliktit të interesit për anëtarët e Komitetit dhe
- Proceset e tjera të ndërlidhura.

Duke iu përgjigjur pozitivisht ftesës së Ministrisë, OBSh – Zyra në Prishtinë, pas kontaktimit me Zyrën Rajonale për Evropë, me seli në Kopenhagë, menjëherë ka filluar aktivitetet, fillimisht duke angazhuar një ekspert lokal (nga mesi i nëntorit – dhjetor 2017) për të bërë analizimin e situatës

në sektorin farmaceutik, duke u fokusuar në proceset që kanë të bëjnë me LBE, raport ky i cili ka shërbyer si pikënisja e punës për ekspertët e OBSH-së, të cilët pastaj kanë pasur dy misione në Kosovë (të parin në janar dhe tjetrin në shkurt 2018).

**MISIONI I PARË** - Në janar 2018, ekspertët nga programi për HTA i OBSH EURO zhvilluan misionin e parë në Kosovë për të mbështetur procesin e reformave për përzgjedhjen dhe prokurimin e barnave esenciale, në mënyrë që të rritet qasja në barna dhe pajisje medicinale sidhe të reduktohen pagesat e pacientëve nga xhepi i tyre për këto produkte. Gjatë këtij misioni u bënë takime të shumta në MSH, IKSHPK, AKPPM, SHSKUK, FSSH, KRPP si dhe OFK. Fokusi kryesor i këtij misioni ishte procesi i revidimit të LBE si dhe prokurimi i produkteve nga kjo listë. Gjithashtu, është diskutuar edhe për hartimin e Udhëzimit Administrativ për rregullimin e çmimit të barnave për produktet nga LBE, që duhet të jetë pjesë e procesit të reformës.

**MISIONI I DYTË** - U mbajt në shkurt dhe objektivat e misionit të dytë ishin më praktike duke qenë se tashmë ishte bërë vlerësimi i detajuar i situatës. Prandaj, në misionin e dytë filloi diskutimi i çështjeve praktike në nivel më teknik, duke definuar proceset të cilat duhet të ndiqen nga MSH në mënyrë që të fillojnë të dy proceset njëkohësisht:

- Revidimi i LBE dhe
- Hartimi (aprovimi) i UA për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve medicinale.

Pas përfundimit të këtyre dy misioneve në Prishtinë, ka vazhduar puna dhe janë zhvilluar disa video-konferenca të ndihmuara nga Zyra e OBSH në Prishtinë me ç'rast edhe janë bërë diskutimet për të përmbyllur këtë fazë të punës, gjegjësisht definimin sa më të mirë të organizimit të procesit të revidimit të LBE në Kosovë.

Nga raportet finale të dorëzuara janë dhënë shumë detaje të cilat janë përpunuar nga MSH në mënyrë që të formohet komisioni i cili punën e vet do ta bazojë në terma të referencës (TOR) sipas rekomandimeve të detajuara nga OBSH, në mënyrë që aplikacionet për barna esenciale të jenë të specifikuar me të dhëna, ashtu që edhe vendimmarrja të mund të bëhet në mënyrë transparente dhe profesionale. Rekomandimet nga raporti final i ekspertëve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (pas dy misioneve) ndërkaq, ishin vlerësuar si një udhërrëfyes i përshtatshëm për fillimin e dizajnimin të krejt procesit të revidimit të Listës së Barnave Esenciale.

## Objektivat

Objektivat ishin kryesisht të përmbledhura në dy pika kryesore në raport me LBE:

- 1.Revidimi i LBE aktuale duke përfshirë klasifikimin VEN (Vital, Esencial, i Nevojshëm) dhe vlerësimin e produkteve që janë në listë, por që nuk përshkruhen dhe;
- 2.Marrjen në konsideratë të proceseve të themelimit të një komisioni të pavarur që do të merrte parasysh:
  - Të dhënat klinike
  - Të dhënat farmako-ekonomike dhe
  - Analizat e ndikimit të buxhetit
  - Aktivitetet që ndërlidhen me çmimet e barnave;
- 3.Transparenca sinjë pikë e veçantë e këtij procesi;
- 4.Harmonizimi edhe i kost-efektivitetit të këtyre barnave esenciale si kriter i asaj që do të quhet esenciale.

### Aprovimi i vendimit

Me qëllim të revidimit të Listës së Barnave Esenciale të Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk ishte reviduar që nga viti 2012, bazuar në kompetencat ligjore, Ministri i Shëndetësisë Uran Ismaili, më 6 gusht 2018 ka emëruar Komitetin teknik për përpilimin e Listës së Produkteve Mjekësore dhe materialeve shpenzuese, sipas propozimeve të institucioneve shëndetësore (Vendimi nr. 37/18, 05-5259, datë 6 gusht 2018).

Komiteti, sipas vendimit të Ministrisë, fillimisht kishte 43 anëtarë, i përbërë nga specialistë të lëmive të ndryshme mjekësore dhe farmaceutike dhe, gjithashtu, edhe përfaqësues të Odave të profesionistëve shëndetësor dhe përfaqësues të Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve (PRAK).

Ky komitet teknik që reflekton një përbërje profesionale nga drejtuesit e klinikave të QKUK-së dhe subjekte të tjera, brenda të cilit ekip përveç specialistëve të fushave mjekësore ka edhe farmacistë dhe përfaqësues të Shoqatës së Pacientëve të Kosovës ka punuar në mënyrë aktive, duke u ndihmuar edhe nga Sekretaria teknike në përgatitjen e draftit të Listës së re të Barnave Esenciale dhe materialit shpenzues për nevojat e institucioneve publike shëndetësore në Kosovë.

Komiteti teknik është asistuar me konsulencë edhe nga ekspertë nga Evropa të Organizatës Botërore të Shëndetësisë që merren me Listën e Barnave Esenciale si dhe është monitoruar nga përfaqësues edhe të Shoqërisë civile si Instituti i Kosovës për Demokraci (KDI) dhe Instituti "Columbus " si dhe çdo organizatë tjetër që ka shprehur interesim, për të marrë pjesë pa asnjë kufizim në të gjitha takimet dhe punëtoritë e Komitetit teknik.

Komiteti është përgjegjës për përpilimin e Listës së produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese, ndërsa lista do të definohet dhe hyjë në fuqi vetëm pas vlerësimit të ndikimit të saj financiar dhe pasi të jenë alokuar mjetet financiare brenda alokimit buxhetor.

## Sesioni i hapur

Procesi i revidimit të Listës së Barnave Esenciale praktikisht nisi më 13 gusht 2018, kur nën kryesimin e Ministrit të Shëndetësisë është mbajtur takimi i parë i anëtarëve të Komitetit teknik për revidimin e Listës së Barnave dhe materialit shpenzues esencial. Anëtarët e këtij komiteti kanë nisur punën me nënshkrim të Deklaratës kundër konfliktit të interesit dhe me njoftimin për përgjegjësitë të cilat i kanë gjatë këtij procesi.

Gjithashtu, anëtarët e Komitetit teknik profesional tashmë kishin të definuar:

- Termat e references (TOR);
- Dokumentin teknik i cili sqaron tërë procesin e aplikimit për secilin produkt;
- Rëndësinë e produktit për shëndetin publik;
- Numrin e pacientëve dhe numrin e pacientëve të ri brenda një viti;
- Alternativat terapeutike;
- Koston totale për të gjithë pacientët;
- Koston e alternativave terapeutike;
- Krahasimet farmako-ekonomike, etj.

Ishte një dakordim i përbashkët se revidimi i Listës së Barnave Esenciale kërkonte përkushtim maksimal, përgjegjësi, analizë të zhvillimeve në industrinë farmaceutike, transparencë dhe llogaridhënie. Synimi ishte i qartë që Lista e Barnave Esenciale që do të përpilohet duhet të përmbush nevojat prioritare të kujdesit shëndetësor të popullatës me një kosto të përballueshme.

Përmes një lidhjeje me "Skype", Nicola Magrini nga Sekretariati për Banat Esenciale në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, përcolli gatishmërinë e OBSH-së që të vazhdojë të përkrah Kosovën në këtë proces dhe gatishmërinë që të ndihmojë me trajnime apo punëtori të nevojshme Komitetin teknik që do të bëjë revidimin e Listës Esenciale të Barnave.

Vet procesi u vlerësua si një aktivitet i rëndësishëm në kuadër të angazhimeve për zbatimin e objektivit kryesor të Strategjisë Sektoriale Shëndetësore dhe Planit të Veprimt (2018-2021) - ruajtjes dhe përparimit të shëndetit të popullatës.

## **Çështjet e përgjithshme**

### **Përafrimi i Listës së Barnave Esenciale dhe udhëzimeve të MSH**

Në bazë të kërkesave të cilat dalin nga Udhëzimi Administrativ nr. 08/2015 Për Udhërrëfyes dhe Protokolle klinike, ekspertët e shëndetësisë i kanë përcaktuar disa fusha prioritare dhe, me këtë rast, kanë përgatitur disa udhërrëfyes klinike, të cilat janë miratuar nga Ministri i Shëndetësisë.

Komiteti për revidimin e Listës së Barnave Esenciale duke marrë parasysh këtë gjë ka vendosur që të gjitha barnat të cilat janë të miratuara në kuadër të këtyre udhërrëfyesve, të jenë edhe pjesë e Listës së Barnave Esenciale.

### **Formati i ri i listës**

Një nga rekomandimet ka qenë edhe kalimi në formatin e listës së OBSH, gjë e cila është realizuar, për ta pasur më të lehtë orientimin, harmonizimin e procedurave, terminologjinë, por edhe strukturimin e tërësishëm dhe renditjen e grupeve të barnave.

Ky grupim i tillë ka mundur edhe analizimin më të lehtë nga ekspertët e OBSH-së.

### **Rritja e mundësive për përballimin e barnave me çmim të lartë**

Krahas procesit të hartimit të LBE, është hartuar dhe nxjerrja e Udhëzimi Administrativ nr. 02/2019 për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve medicinale si akt që ndihmon në uljen e çmimit të barnave. Ky udhëzim është harmonizuar gjithashtu edhe me udhëzimet e ngjashme të vendeve perëndimore dhe ka kaluar në shumë diskutime e konsultime, si në vend ashtu edhe jashtë vendit, duke pasur edhe ndihmën e madhe të OBSH, përkatësisht ekspertëve nga Kopenhaga (Zyra e OBSH Euro dhe Vjena, Zyra Referente e OBSH për çmime dhe reimbursim).

Në kohën sa UA për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve medicinale, i përgatitur nga MSH, ka qenë si draft, atë e ka reviduar grupi i ekspertëve të OBSH dhe i ka dhënë rekomandimet e veta.

Pas të gjitha fazave procedurale, përfshirë edhe konsultimet publike, Udhëzimi është aprovuar nga Ministri i Shëndetësisë, në qershor 2019.

## Komiteti dhe nënkomitetet

Me qëllim të racionalizimit të punës dhe mbështetjes së tij, Komiteti teknik që në takimin e tij të dytë kishte si përkrahje Sekretarinë teknike të emëruar gjithashtu nga Ministri, ndërsa për qëllime praktike, në kuadër të Komitetit, u themeluan nënkomitetet teknike të ndara, sipas grupeve farmakoterapeutike:

- Nënkomiteti për Anestetikë; Analgjetikë; Antialergjikë dhe Antiemetikë
- Nënkomiteti për Anti-infektivë: Antituberkularë; ARV dhe Citostatikë
- Nënkomiteti për Kardiovaskularë; Diuretikë; Respiratorë; Hormone dhe Antidiabetikë
- Nënkomiteti për Gjinekologji; Kontraceptivë dhe Neonatologji
- Nënkomiteti për Psikoterapeutikë; Antiparkinsonikë; Antikonvulzantë; ORL; Oftalmo; Maxillofaciale dhe Neurokirurgji;
- Nënkomiteti për Fluide dhe produkte të Gjakut; Vitaminat; Minerale; Imunoglobulinat; Vaksinat dhe Imunosupresorët
- Nënkomiteti për Pajisje Radiologjike dhe të tjera, dhe
- Nënkomiteti për Kirurgji dhe sëmundje të rralla.

Pas emërimit të Komitetit teknik për përpilimin e Listës së produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese, sipas propozimeve të institucioneve, në takim in inauguroes të këtij Komiteti që është mbajtur më 13 gusht 2018 në Prishtinë, pas njohjes së anëtarëve me përgjegjësitë e tyre, është vendosur që MSH të hap procesin e aplikimit për Listën e Barnave esenciale, duke njoftuar përmes takimeve, ueb faqes së MSh-së dhe profilit të saj zyrtar në facebook (FB), thirrjeve publike përmes Radio- televizionit publik të Kosovës dhe mediave të tjera (të shkruara dhe elektronike) të gjitha palët e interesuara, që të bëhen pjesëmarrëse përmes propozimeve për produkte, material shpenzues dhe pajisje mjekësore.

Aplikacioni përbëhet me të dhëna që përfshijnë:

- Propozimi dhe Aplikanti (duke përfshirë spitalin dhe klinikën përkatëse)
- Seksioni në Listën Esenciale dhe indikacioni
- Forma e dozimit dhe fortësia e barit
- Historiku (a ka qenë edhe më herët në LE, sidhe a është në Listën Esenciale të OBSH)
- Rëndësia për shëndetin publik (me referenca nga punimet shkencore)
- Përmbledhje e evidencës – përfitimet
- Përmbledhje e evidencës – dëmet
- Evidencë shtesë
- Udhërrëfyesit e OBSH apo Udhërrëfyesit vendorë
- Kostoja për sasinë e cila nevojitet në sistemin shëndetësor
- Kost-efektiviteti – analiza farmako-ekonomike në raport me alternativat
- Statusi i regjistrimit në AKPPM



- Nëse është i regjistruar – të shënohen alternativat e regjistruara
- Nëse nuk është i regjistruar – të shënohet alternative terapeutike
- Rekomandimet e komisionit
- Referenca

Ndërkohë, përmes mjeteve të komunikimit të MSH-së me publikun, ishte bërë edhe hapja e thirrjes publike për përfshirje të produkteve në Listën Barnave Esenciale që do të revidohej; duke i inkurajuar institucionet shëndetësore, profesionistët shëndetësor, subjektet farmaceutike dhe palët e interesuara që të bëhën pjesë e procesit.

Me qëllim të sigurimit të informacioneve kryesore për subjekte e interesuara dhe publikun në përgjithësi, që në fillim të procesit në ueb faqen e MSH-së janë publikuar material si:

- Informatat për aplikuesit
- Dokumente rreth shpjegimit të çështjes së konfliktit të interesit
- Dokumenti-Koncepti i barnave esnenciale
- Formulari i aplikimit
- Deklarata mbi Konfliktin e Interesit
- Procesverbale dhe komunikata nga takimet.

Nënkomitetet ndërkaq, që në tetor 2018, kishin një punëtori intensive me tre ekspertë të OBSH-së (Z. Nikolla Magrini, Z. Lorenzo Moja dhe z. Guillaume Dedet) për të sqaruar sa më mirë aspektet për mënyrën e vlerësimit të produkteve që do të përfshiheshin në LBE.

Me qëllim të familjarizimit me procesin dhe sqarimit të aspekteve profesionale lidhur me procesin e revidimit të Listës së Barnave Esenciale, në veçanti për Citostatikë; më 27 shtator 2018, anëtarët e Komitetit Teknik për revidimin e LBE kanë zhvilluar në Qendrën Kombëtare të Telemjekësisë së Kosovës një trajnim njëditor interaktiv dhe të drejtpërdrejt në temën: Barnat esenciale për kancer: "Problemet dhe zgjidhjet e mundshme", me Prof. Dr. Franko Cavalli, President i Institutit për Hulumtime Onkologjike (Zvicër) dhe President i Forumit Botëror të Onkologjisë (World Oncology Forum).

Ndërkohë, më 10, 11 dhe 12, dhe 13 tetor 2018, tre ekspertë të OBSH-së: Nikolla Magrini, Lorenzo Moja (OBSH-HQ) dhe Guillaume Dedet, Zyra Rajonale e OBSH-së, me përkrahjen e Zyrës së OBSH-së në Prishtinë kanë mbajtur punëtori tre ditore me anëtarët e Komitetit të Listës së Barnave Esenciale.

Në këtë punëtori, duke marrë parasysh kërkesën e subjekteve të ndryshme farmaceutike, është vendosur që afati për aplikimet për përfshirjen e barnave të reja dhe ndryshimet ose fshirjen e barnave aktualisht të listuara, në Modelin e listës të 2018 të shtyhet (nga 10 tetor) deri me datë 31 tetor 2018.

Periudha e aplikimit është zgjeruar për të lehtësuar bashkëveprimin ndërmjet aplikantëve dhe Sekretarisë së Komitetit teknik për revidimin e LBE, për të siguruar që aplikacionet adresojnë në mënyrë adekuate elementet kritike për përzgjedhjen: rëndësinë e shëndetit publik, efikasitetin klinik dhe sigurinë e barit të propozuar.

Ndryshe, përmes punës në grupe punuese paralele, punësoria është zhvilluar për tri ditë në Prishtinë, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe për temë ka pasur: "Vendosjen e prioritetëve në mënyrë të drejtë për hartimin e Listës (së re) të Barnave Esenciale (LBE)".

Pas mbylljes së periudhës së aplikacioneve për subjektet e interesuara farmaceutike, profesionistët shëndetësor, shoqatat e ndryshme, institucionet shëndetësore apo dhe nga vet pacientë e qytetarë, Sekretaria e Komitetit ka përgatitur një draft me të gjitha propozimet e marra, i cili i është prezantuar Komitetit, përkatësisht nënkomiteteve teknike për punë të mëtejme në të.

Me që shumica e aplikuesve kanë aplikuar edhe në formë fizike edhe përmes formës elektronike, Sekretaria ka shqyrtuar të dy format e aplikimit, duke bërë krahasimin e aplikacioneve dhe evitimin e regjistrimit të dyfishtë të produkteve.

Duhet theksuar se në fillim numri i aplikacioneve ishte i vogël, por pas zgjatjes së afatit, nga 10 në 31 tetor 2018 ishte rritur dukshëm.

Sipas të dhënave, janë pranuar rreth **350 propozime** për produkte dhe pajisje të ndryshme medicinale (duke përfshirë edhe materialin shpenzues).

Në hartimin e Draft listës me propozimet e subjekteve farmaceutike (faza e parë) Sekretaria e Komitetit ka punuar rreth dy javë në listimin e të gjitha propozimeve një nga një në një listë të përbashkët, të krijuar në formatin excel, në të cilën janë renditur propozimet duke i listuar dhe bashkëngjitur propozimit të dhënat si në vijim për produktet:

- Emrin gjenerik të produktit (INN)
- Emrin e mbrojtur
- Prodhuesin
- Formën farmaceutike
- Fortësinë
- ATC Kodin dhe
- Grupin farmako-terapeutik.

Pas krijimit të listës me aplikimet deri në atë fazë, Sekretaria e Komitetit, të gjitha propozimet (produktet dhe pajisjet) i ka ndarë për nënkomitetet, me qëllim që atyre t'u lehtësohet puna në vijim të procesit.

Në bashkëpunim me ekspertët e OBSh-së, të cilët kanë qëndruar në Prishtinë më 10, 11 dhe 12 tetor, për të zhvilluar punëtorinë tri ditore, për Komitetin dhe nënkomitetet është krijuar edhe një model (template) për propozimet që në ndërkohë do të pranohen nga SHSKUK (Klinikat e QKUK-

së dhe spitalet e përgjithshme) dhe institucionet e tjera shëndetësore për përfshirje të produkteve të ndryshme në LBE, deri në ditën kur përfundon procesi.

Pas mbylljes së fazës së parë të pranimit të aplikacioneve nga subjektet farmaceutike, Komiteti ka hapur fazën e dytë të aplikacioneve për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, duke njoftuar klinikat për aplikime edhe përmes Sekretarisë së Komitetit, përmes Drejtorit ekzekutiv të SHSKUK-së dhe anëtarëve të klinikave të përfaqësuar në Komitet.

Me qëllim që edhe propozimet nga Klinikat të jenë gjithëpërfshirëse, edhe afati për aplikimin e tyre është shtyrë prej 6 dhjetorit deri më 31 dhjetor, me qëllim që në janar, Sekretaria ta ketë mundësinë e përpunimit të propozimeve të dhëna.

Pas disa takimeve, Komiteti ka shqyrtuar propozimet e marra nga shumica absolute e Klinikave të QKUK-së, të cilat është dashur të analizojnë:

- Listën Esenciale aktuale në fuqi
- Barnat të cilat janë pjesë e Listës, por që nuk janë porositur ndonjëherë nga klinikat
- Propozimet e reja për barna dhe materiale shpenzuese
- Propozimet për largime të disa barnave nga lista
- Propozimet e subjekteve farmaceutike
- Propozimet e shoqatave profesionale, dhe
- Propozime individuale nga profesionistët apo qytetarët/pacientët.

Në janar 2019, Sekretaria i ka prezantuar Komitetit Draftin e LBE sipas modelit të OBSH-së.

Në ndërkohë, eksperti i OBSH-së, Lorenzo Moja nga OBSH i ka asistuar Komitetit edhe në punëtorinë e dytë tre ditore të mbajtur në Prishtinë nga Komiteti teknik (10-21 dhjetor 2018), ndërsa përfaqësuesi i Komitetit Arianit Jakupi në Janar 2019 ka marrë pjesë në Gjenevë në Konferencën e OBSH-së për Listën e Barnave Esenciale, me qëllim të aplikimit në finalizimin e LBE të Kosovës sipas modelit të kësaj organizate.

Në mars 2019, pas dy raundeve të vizitave nëpër klinikat e QKUK-se me qëllim të përmbledhjes së propozimeve finale, përcaktimit të sasive të planifikuara vjetore dhe kostos financiare, Sekretaria ka përgatitur (së bashku me z. Arianit Jakupi) draftin parafinal të Listës së Barnave Esenciale (2019) në Kosovë.

Ky draft, pas diskutimeve në komitet është dërguar për komentim edhe Në zyrën e OBSH në Gjenevë, përkatësisht në Sekretariatën e listës së barnave esenciale me ç'rast edhe janë pranuar komentet shumë të vlefshme për produktet të cilat nuk janë rekomanduar që në këtë fazë të jenë pjesë e listës së barnave esenciale.

## **Propozimi për listën diagnostike dhe listat e tjera**

Komiteti ka pasur shumë aplikacione për produkte dhe pajisje të ndryshme dhe për të qenë më të strukturuar dhe më efikas gjatë punës dhe analizës së tyre ka bërë edhe ndarjen e grupeve të mëdha:

- 1.Lista e barnave esenciale
- 2.Lista e pajisjeve esenciale (ku përfshihet edhe materiali shpenzues medicinal)
- 3.Lista e produkteve diagnostike
- 4.Lista e pajisjeve asistive esenciale

Përveç Listës së Barnave Esenciale (komponenti i barnave), listat e tjera (pajisjet esenciale, produktet diagnostike dhe pajisjet asistive) janë në process të hartimit dhe, para finalizimit, Komiteti do të marr në konsideratë ekspertizën dhe konsulencën ndërkombëtare me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit.

## **Përmbledhje**

### **Drafti parafinal**

Drafti parafinal i Listës së Barnave Esenciale, ka përfshirë barnat nga:

- Lista në fuqi e OBSH-së;
- Produkte nga Lista e Barnave Esenciale në fuqi (2012), dhe
- Propozimet e reja për përfshirje në këtë listë me arsyetimet përkatëse.

Kostoja financiare e draft listës kap shumën prej 47 milionë eurove, e cila më tej është klasifikuar edhe në listën komplementare duke e zbritur kështu listën bazike në 35 milionë duke synuar që kjo listë të reflektojë buxhetin e barnave të ndara në kuadër të buxhetit të shëndetësisë. Pra, pas një pune intensive, transparente, dhe një trajtimi shumë dimensional të propozimeve të bëra, Lista është finalizuar, duke marrë në konsideratë edhe ndonjë debat apo konsultim shtesë me palët e interesuara, me të vetmin qëllim që procesi, ashtu si ka filluar në mënyrë transparente, ashtu edhe të përmbyllet.

Për më tepër, draft lista për më shumë se dy javë (30 korrik-21 gusht 2019) ka qenë e publikuar për komente edhe në platformën e konsultimeve publike të Qeverisë së Republikës së Kosovës me qëllim të rritjes së transparencës dhe sigurimit që procesi ka përfshirë të gjitha aspektet e një politike të drejtë dhe transparente nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Natyrisht, Komiteti teknik ka marrë parasysh sygjerimet e arsyetuara nga profesionistët shëndetësor-specialistët e fushave të mjekësisë, duke ditur faktin se vet specialistët e fushave të mjekësisë janë të përfaqësuar në këtë Komitet. Përveç propozimeve nga subjektet farmaceutike, anëtarët e Komitetit, kanë pranuar dhe shqyrtuar në vazhdimësi propozimet edhe nga drejtuesit e klinikave të QKUK-së, të cilët në vazhdimësi në vijë hierarkike janë njoftuar dhe kanë qenë të kyçur në procesin e hartimit të Listës së Barnave Esenciale.

## **Antibiotikët**

Për të ndihmuar në programimin e kujdestarisë së antibiotikëve në nivelin lokal, nacional dhe global, si dhe për të ulur shkallën e rezistencës antimikrobike, Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përgatitur klasifikimin e antibiotikëve në kategorinë AWARE. Kjo është shkurtësë e fjalëve Access (Qasje), Watch (mbikëqyrje/përcjellje) dhe reserve (rezervë) që nënkupton klasifikimin e antibiotikëve në grupe të ndryshme për të theksuar rëndësinë e përdorimit korrekt të tyre në trajtimin e infeksioneve të ndryshme.

Kjo qasje është bërë edhe pjesë e Planit Strategjik për Rezistencën Antimikrobike 2019-2021, të nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë më 05.12.2018 dhe përkon me objektivën specifike 1.4. (përdorimi i drejtë i antibiotikëve në mjekësinë humane e veterinare) dhe aktivitetin 1.4.3. - aprovimi i dokumentit për restriksionin e përdorimit të antibiotikëve në kujdesin parësor, dytësor dhe në QKUK.

### **Antibiotikët e Grupit Acces (Të qasshëm)**

Ky grup, përfshin antibiotikët, të cilët kanë aktivitet kundër një numri të madh të mikrobeve të ndryshme patogjene, të cilat tregojnë potencial më të ulët të rezistencës sesa antibiotikët në grupet e tjera. Disa antibiotikë të këtij grupi rekomandohen si opsioni kryesor i parë ose i dytë në terapinë empirike për infeksionet e ndryshme. Antibiotikët e këtij grupi janë thelbësor dhe popullata duhet të ketë qasje të plotë në to, të jenë të përballueshëm dhe të kenë cilësi të siguruar.

### **Antibiotikët e Grupit WATCH (mbikëqyrje/përcjellje)**

Ky grup përfshin klasët e antibiotikëve që kanë potencial më të lartë të shfaqjes së rezistencës dhe përfshin shumicën e agjentëve me prioritet të lartë në mesin e Antimikrobikëve me rëndësi kritike për mjekësinë humane<sup>1</sup> dhe / ose antibiotikët që kanë rrezik relativisht të lartë të shkaktojnë rezistencë bakteriale. Këto barna duhet të kenë prioritet si objektiva kryesor të programeve të monitorimit dhe kujdestarisë së antibiotikëve. Disa antibiotikë të grupit Watch rekomandohen si opsioni kryesor i parë ose i dytë në terapinë empirike për një numër të kufizuar të infeksioneve dhe ato janë dhënë në listën e mëposhtme

<sup>1</sup><http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/251715/1/9789241511469-eng.pdf?ua=1>

### **Antibiotikët e Grupit rezervë**

Ky grup përfshin antibiotikë dhe klasë të antibiotikëve, të cilët duhet të rezervohen për trajtimin e infeksioneve të konfirmuara ose ato që dyshohet se janë shkaktuar nga mikroorganizmat

multirezistentë ndaj terapisë. Antibiotikët e grupit rezervë duhet të konsiderohen si "opsioni i fundit" terapeutik. Disa prej antibiotikëve të grupit rezervë renditen si barna individuale nëpër Lista të barnave, kur ato kanë më shumë dobi sesa rrezik dhe aktivitet të dëshmuar kundër mikrobeve patogjene me "prioriteti kritik" ose "prioritet të lartë" të identifikuar nga Lista e Patogjenëve Prioritarë të OBSH-së, veçanërisht Enterobakteret rezistente ndaj karbapenemeve. Këta antibiotikë duhet të jenë të qasshëm, por përdorimi i tyre duhet të përshtatet për pacientë dhe institucione shumë specifike, atëherë kur të gjitha alternativat e tjera kanë dështuar ose nuk janë të përshtatshme për zbatim. Këto barna mund të mbrohen dhe të përcaktohen me përparësi si synime kryesore të programeve të kujdestarisë së antibiotikëve që përfshijnë raportimin e monitorimit dhe përdorimit, me qëllim që të ruhet efektiviteti i tyre.

Në Kujdesin Parësor Shëndetësor në Kosovë, cefalosporinat e gjeneratës së tretë, të katërt dhe të pestë duhet të jenë vetëm në grupin rezervë të antibiotikëve. Ato duhet të përkruhen vetëm në rastet e ripërshkrimit të terapisë nga specialisti pas lëshimit nga spitali dhe në rastet e pneumonisë komunitare me pasqyrë të rëndë klinike.

Pasi që përdorimi i ceftriksonit në Kosovë e ka shkallën më të lartë në Evropë dhe përdorimi i pakontrolluar i tij nxit shfaqjen dhe përhapjen e rezistencës antimikrobike, çdo përshkrim i ceftriksonit në Kujdesin Parësor do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe inspektimit të detajuar nga organet kompetente të MSH.

Në institucionet e Kujdesit Shëndetësor Dytësor dhe Tretësor, në grupin e antibiotikëve rezervë do të jenë këta antibiotikë: kolistina, imipenemi, meropenemi, ertapenemi, daptomicina, linezolidi, fosfomicina, quinipristin/dalfopristin dhe tigeciklina.

## **Arsyetimi**

Në dekadën e fundit në Kosovë përshkrimi, dispenzimi dhe administrimi i antibiotikëve është bërë pa kontroll institucional (në shumicën e rasteve antibiotikët nuk janë përshkruar në bazë të farmakoterapisë racionale, nuk është përshkruar receta, farmacistët kanë dhënë antibiotikë pa recetë, pacientët kanë përdorur antibiotikë pa konsultim nga mjeku, antibiotikët nuk janë përshkruar me emra gjenerikë, etj.). Rezultatet e mbikëqyrjes në të gjitha nivelet kanë dhënë shifra alarmante të konsumit të antibiotikëve, me theks të veçantë në përdorimin e cefalosporinave të gjeneratës së tretë në Kujdesin Parësor, si dhe karbapenemet në Kujdesin Tretësor. Kosova e ka shkallën proporcionale të përdorimit parenteral të ceftriksonit më të lartën në Evropë (53.9%). Ceftriksoni është antibiotiku më i përshkruar në 7 spitalet e Kosovës (41.5%) dhe, po ashtu, shumë shpesh përshkruhet në Kujdesin Parësor. Mikroorganizmat indikatorë të rezistencës janë 2-5 herë më të lartë sesa mesatarja evropiane për të gjithë antibiotikët e përdorur në praktikën klinike dhe ambulatore.

## **Workshopi final dhe aprovimi në parim**

Më datë 22 korrik 2019 eksperti i OBSH Z. Nicola Magrini ka marrë pjesë në punëtorinë e fundit në të cilën është diskutuar në përgjithësi për tërë procesin e e Listës së Barnave Esenciale, duke u diskutuar në detaje produktet më specifike, sidomos ato të cilat marrin buxhet më të lartë.

Anëtarët e Komitetit kanë pasur mundësi të hapur të diskutimeve dhe, me këtë rast, duke analizuar edhe specifikat e vendit janë marrë vendime për aprovimin – mosaprovimin e produkteve, të cilat do të jenë apo jo pjesë e Listës së (re) të Barnave Esenciale.

Kjo punëtori ka qenë e organizuar pas shumë video-konferencave dhe analizimit të tërësishëm të draftit të listës me të gjitha aplikacionet e aprovuara nga nënkomitetet deri në atë fazë, dhe më tej, pas analizimit nga ekspertët e OBSH- Gjenevë, duke pasur një pasqyrë të përgjithshme të aplikacioneve.

Duke përcjellë një kronologji të kalimit të listës sipas renditjes së grupeve të barnave ashtu edhe janë dhënë rekomandimet finale.

## **Diskutimi publik**

Pas aprovimit të listës në parim nga ana e Komitetit, sipas procedurave të parapara lista është publikuar zyrtarisht për diskutim publik dy javor dhe pas kalimit të këtij afati janë pranuar rreth 85 komente dhe rekomandime të cilat fillimisht janë trajtuar nga Sekretaria në tri takime të ndara dhe janë bërë adresimet adekuate të cilat i janë dërguar Komitetit për aprovim.

## **Aprovimi i listës**

Komiteti teknik, prej themelimit të tij më 6 gusht dhe inaugurimit më 21 gusht 2019 ka mbajtur gjithsej 20 takime (kryesisht në Qendrën e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare dhe tre punëtori me prani të ekspertëve të OBSH-së). Më datë 21 gusht 2019, pas kalimit të fazës së konsultimeve publike, Komiteti mbajti takimin e 18-të me rradhë dhe morri vendim për të gjitha komentet të cilat ishin pranuar. Në këtë takim, gjithashtu, u vendos edhe përndarjen e disa produkteve të cilët do të jenë në listën komplementare (megjithëse për shumicën prej tyre ishte vendosur edhe sipas rekomandimeve nga punëtorja e fundit e datës 22 korrik).

Pas një pune intensive, transparente, dhe një trajtimi shumë dimensional të propozimeve të bëra, Lista e Barnave Esenciale u finalizua, duke pasur synimin që gjatë kohës sa do të jetë në zbatim, institucioneve shëndetësore t'u mundësojë një planifikim sa më të saktë të shpenzimeve, kosto të qartë financiare dhe pacientëve terapi gjithëpërfshirëse, bazuar në mbulueshmërinë financiare të kësaj liste.

Ky draft final i aprovuar nga Komiteti përfundimisht i dorëzohet Ministrisë të Shëndetësisë për miratim.



## **Përparësitë me listën e re të barnave esenciale**

Krahasuar me Listën e Barnave Esenciale të vitit 2012, LBE e re ka sjellë një varg përparësisht siç janë:

- Kalimi në formatin e plotë të OBSH
- Eliminimi i interpretimeve të gabueshme të specifikacioneve të produkteve të cilat pastaj kanë sjellë probleme të shumta në kontraktim
- Eliminimi i produkteve të cilat nuk janë përdorur
- Sjellja në listë e risive të cilat e pasurojnë atë
- Ridefinimi i listës së anestetikëve, duke i sqaruar edhe produktet specifike sipas procedurave të ndryshme të anestezisë (sidomos për raste specifike janë paraparë produkte të cilat janë të domosdoshme)
- Ridizajnimi i listës së antibiotikëve sipas kalasifikimit të ri të OBSH – AWARE (Access – Watch and Reserve), që duke i ndarë antibiotikët në tri kategori domosdoshmërisht krijon tre grupe, duke e përcaktuar edhe një hierarki të mënyrës së përshkrimit të tyre duke filluar nga grupi access. Krejt kjo në luftën globale kundër rezistencës antimikrobike.
- Ridefinimi sipas formatit të ri të listave për Tuberkuloz dhe për HIV – anti-retroviralët
- Përfshirja në listë e barnave për trajtimin e Hepatit C (megjithëse sa i përket fondeve për kategoritë e tilla do të diskutohet pasi do të ndajmë një fond të veçantë)
- Plotësimi i listës së barnave për përdorim në Onkologji dhe Hematologji - shtimi në listë i imunoterapisë, e cila po përfshihet për herë të parë. Gjithashtu, janë shtuar edhe disa produkte të reja për trajtimin e kancerit të gjirit (duke dashur që t'u jepet prioritet atyre formave kanceroze të cilat janë më të shpeshtat dhe t'u dilet në ndihmë sa më shumë pacientëve)
- Shtimi i disa produkteve të domosdoshme për trajtimin e sëmundjeve vaskulare
- Trajtimi me seriozitet e barnave antidiabetike – duke krijuar fillimisht një udhërrëfyes dhe protokoll klinik për trajtimin e pacientëve diabetik sidomos ata insulinë vartës (duke qenë se edhe kjo kategori ka qenë me konsum monetar të konsiderueshëm)
- Pasurimi i listës së produkteve për shëndetin mendor
- Pasurimi i listës së fluideve për Kujdesin intensiv dhe Emergjencë
- Lista produkteve për trajtimin e sëmundjeve të rralla, e cila do të kërkojë një fond të veçantë

## **Kronologjia sipas grupeve të produkteve dhe mbi 100 barna të shtuara**

- Te anestetikët janë shtuar disa forma të reja farmaceutike me ç'rast do të ketë një përmirësim të ndjeshëm të rezultateve nga anestezia dhe kualiteti i shërbimit për pacientët
- Te barnat kundër dhembjes janë shtuar në listën bazike produktet oksikodon dhe fentanil në formë flasteri dhe kjo posaçërisht për pacientët në stadi terminal të kancerit që sadopak t'u dilet në ndihmë për trajtimin e dhembjes
- Antiepileptikët 2 produkte në disa forma, duke e shtuar kështu listën edhe me disa barna të domosdoshme për kategori të pacientëve
- Antiinfektivët
- Një produkt për trajtimin e sëmundjeve parazitare
- 7 produkte të antibakterialët dhe klasifikimi i ri AWARE sipas OBSH
- Një produkt të antituberkularët
- Tri produkte antifungale (kundër kërpudhave)
- Katër produkte për trajtimin e HIV
- 2 produkte si antiviral të tjerë (trajtimi i Gripit AH5N1 dhe AH1N1)
- HEPATITI C – si kategori e veçantë - 1 produkt për këtë kategori
- 6 produkte të barnat imunosupresore
- 10 produkte citotoksike dhe adjuvante
- 2 lloje të hormoneve
- 6 lloje – produkt që ndikojnë në gjak
- 3 lloje të faktorët e rinj të koagulimit
- 6 lloje shtesë të barnat anti-hipertenzive
- 6 lloje të reja të produktet për sëmundjet e lëkurës
- 1 produkt të antiseptikët
- 4 produkte për trajtimin e sëmundjeve të lukthit (trakti gastrointestinal)
- 4 produkte të reja të kontrceptivët
- 5 produkte të reja për diabet
- Vaksinat- Shtimi i disa llojeve të reja dhe përmirësimi i valeneave të vaksinave ekzistuese – që d.m.th rritje e mbulueshmërisë së këtyre vaksinave
- Për herë të parë trajtimi i Human Papilloma Virusit të femrat e reja
- 6 produkte të reja për trajtimin e problemeve të syve – oftalmologjike
- 6 produkte për trajtimin e problemeve mendore dhe përmirësimi i formave farmaceutike të produkteve aktuale, duke i bërë më të përshtatshme për administrim (sidomos duke ditur kompleksitetin e këtyre sëmundjeve)
- 4 produkte të trakti respirator
- 2 produkte shtesë të kujdesi neonatal
- Të tjera: – Skleroza multiple, Fibroza cistike, Tirozinemia, Morbus Gaucher, hipertensionioni pulmonar – kryesisht për sëmundjet e rralla.

## Konsultimet publike dhe transparencja

Në procesin e përpilimit të LBE, MSh i ka kushtuar rëndësi të veçantë transparencës, me qëllim që procesi të jetë gjithëpërfshirës, i besueshëm dhe gjatë gjithë kohës komunitetin mjekësor dhe publikun e gjerë ta mbajë të informuar për secilin hap të zhvilluar. Për këtë qëllim janë ndërmarrë disa veprime si:

Është krijuar linku i veçantë në ueb faqe të MSh-së: Revidimi i Listës së Barnave Esenciale, ku publikohen të gjitha materialet dhe vendimet lidhur me procesin;

<https://MSh.rks-gov.net/publikimet/revidimi-i-listes-se-barnave-esenciale/>.

Hapja e procesit të ofertave është bërë përmes thirrjeve publike të publikuara në media të shkruara (gazeta ditore) dhe në rrjetet sociale si dhe në profilin zyrtar të MSh-së në facebook;

Një njoftim në formë të reklamës për ditë të tërë është transmetuar përmes Radiotelevizionit publik të Kosovës (i transmetuar pa pagesë);

Më 23 tetor, me Institutin "Columbus" dhe me pjesëmarrje të Ministrit, profesionistëve shëndetësorë, anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Kuvendit të Kosovës, subjekteve farmaceutike, mediave, etj., është mbajtur debat lidhur me Listën e re të Barnave Esenciale;

Në nëntor, në KTV, është mbajtur një debat televiziv lidhur me LBE me pjesëmarrje të Ministrit, Odës së Farmacistëve të Kosovës; Shoqatës së Distributorëve Farmaceutikë dhe Mediave-Institutit "Columbus".

Divizioni i Komunikimit me Publikun ka dhënë përgjigje në vazhdimësi në pyetjet e mediave dhe palëve të tjera të interesit lidhur me procesin e revidimit të LBE. Prosesi i revidimit të LBE-së është përcjellë me interesim të madh nga publiku dhe mediat, siç mund të shihet edhe nga linqet e poshtëshënuara:

- <https://MSh.rks-gov.net/publikimet/revidimi-i-listes-se-barnave-esenciale/>
- <https://MSh.rks-gov.net/agjensioni-antikorrupsion-lavderon-ministrin-ismaili-per-ftesen-qe-ky-agjension-te-perfshihet-ne-revidimin-e-listes-se-barnave-esenciale/>
- <https://www.koha.net/arberi/124586/lista-esenciale-e-barnave-shpesh-eshte-ndertuar-ne-baze-te-interesave-te-kompanive-farmaceutike/>
- <https://www.epokaere.com/revidimi-i-listes-esenciale-te-barnave-perfundon-brenda-disa-muajsh/>
- <https://kallxo.com/shkurt/ministri-shendetesise-jo-lista-esenciale-te-barnave-per-interesa-biznesore/>
- <http://aab-edu.net/media/gazetakn/ismaili-jemi-ne-perfundim-te-revidimit-te-listes-se-barnave-esenciale/>
- <http://gazetaevropa.net/lista-esenciale-e-barnave-nuk-u-revidua-qe-nga-viti-2012/>

- <https://www.periskopi.com/lista-esenciale-e-barnave-ne-kosove-nuk-eshte-perditesuar-qe-6-vjet/>
- <http://www.arbresh.info/aktuale/mungesa-e-barnave-synohet-krijimi-i-nje-liste-te-re-esenciale/>
- <https://klankosova.tv/ismaili-lista-e-re-e-barnave-esenciale-do-ti-permbushe-nevojat-e-pacienteve/>
- <https://www.periskopi.com/lista-esenciale-e-barnave-ne-kosove-nuk-eshte-perditesuar-qe-6-vjet/>
- <https://zyrtare.com/2018/10/ismaili-lista-e-re-e-barnave-esenciale-do-ti-permbushe-nevojat-e-pacienteve/>
- <https://www.botasot.info/kosova/822842/ministri-i-shendetesise-jo-lista-esenciale-te-barnave-per-interesa-biznesore/>
- <http://ulpianapress.com/qe-5-vite-nuk-eshte-reviduar-lista-esenciale-e-barnave/>
- <https://www.facebook.com/ofkosova/posts/lista-e-barnave-esenciale-ne-proces-te-revidimitkryetari-i-ofk-arianit-jakupi-gj/1866875633410715/>
- <https://kosova-info.com/lista-e-re-e-barnave-esenciale-e-gatshme-ne-muajin-maj/>
- <https://kosova-info.com/lista-e-re-e-barnave-esenciale-e-gatshme-ne-muajin-maj/>
- <http://www.njeshi.com/index.php/2019/06/26/ministri-ismaili-semundjet-e-rralla-jane-perfshire-ne-listen-e-barnave-esenciale/>
- <https://kallxo.com/shkurt/deputetet-premtojne-futjen-e-barnave-per-fibroze-cistike-ne-listen-esenciale/>
- <https://zeri.info/aktuale/200296/lista-esenciale-e-barnave-pa-shume-barna-te-rendesishme/>
- <http://prizrenpress.com/lajme/nis-revidimi-i-listes-esenciale-te-barnave/>

Gjithashtu, MSh që në hapje të procesit i ka ftuar të gjitha palët e interesuara (nga shoqëria civile) që ta monitorojnë procesin e revidimit të LBE, duke mundësuar pjesëmarrje të plotë në takimet e Komitetit, dhe punëtoritë e mbajtura për të gjithë të interesuarit.

MSh ka pranuar qysh në fillim të procesit edhe kërkesën e Institutit "Columbus" dhe KDI-së që të jenë monitoruese të procesit të revidimit të Listës së Barnave Esenciale dhe përfaqësuesit e tyre janë ftuar për të marrë pjesë rregullisht në takimet dhe punëtoritë e Komitetit teknik si dhe janë ndarë me to dokumentet dhe draftet e LBE në secilën fazë të zhvillimit të tyre.

<b>Tabela 1. Barnat me kufizim ne moshe apo peshë</b>	
atropine	> 3 muajsh
benzyl benzoate	>2 vjeç
betamethason përgatesat topikale	hidrokortizoni preferohet te neonatet
cefazolin	>1 muajsh
ceftriaxone	>41 javë e korrektuar e moshes gestative
darunavir	> 3 vjeç
dolutegravir	≥25 kg
doxycycline	>8 vjeç (përveç infeksioneve serioze psh te kolera)
efavirenz	>3 vjeç apo >10 kg
fluoxetine	>8 vjeç
ibuprofen	>3 muajsh (përveç format IV për patent ductus arteriosus)
metoclopramide	Jo te neonatët
nevirapine	> 6 javë
ondansetron	>1 muajsh
silver sulfadiazine	>2 muajsh
tetracaine	Jo te neonatet
xylometazoline	>3 muajsh

<b>Tabela 2. Sqarime për format farmaceutike</b>	
<b>A. Administrimi oral</b>	
Format e forta farmaceutike orale	I referohet tabletave apo kapsulave apo edhe formave tjera te forta duke nenkuptuar se nuk ka ndonje ndryshim ne efikasitetin klinik ne mes tyre. Mirëpo në asnje rast kjo nuk nënkupton format me lirim të modifikuar
Tableta	I referohet tabletave me apo pa film apo drazhe, tabletave ndarëse, tabletave përtpëse, përshkumëzuese etj. ato që treten në ujë apo ndonjë lëng tjetër. Mirëpo në asnje rast kjo nuk nënkupton format me lirim të modifikuar
Tableta (me kualifikim)	I referohet rasteve specifike të ndonjë lloji të tabletës: si tableta përtpëse, tretëse, të ndara, sublinguale apo edhe rastet kur tableta mund të ketë lirim të modifikuar
Kapsula	I referohet kapsulave të forta apo të buta. Termi "kapsulë" pa ndonjë kualifikim asnjëherë nuk nënkupton ndonjë lloj kapsule me lirim të modifikuar
Kapsula (me kualifikim)	Termi kapsulë me kualifikim i referohet kapsulave gastro-rezistente apo atyre me lirim të modifikuar.
Granula	Përgatesa të cilat i jepen pacientit që të gëlltiten pa ndonjë përgatitje tjetër, të përtpen apo të merren në apo me ujë apo ndonje lëng tjetër të përshtatshëm. Termi "granulë" pa ndonjë kualifikim asnjëherë nuk nënkupton ndonjë lloj kapsule me lirim të modifikuar
Pluhur oral	Përgatesa të cilat i jepen pacientit si pluhur (zakonisht mono dozë) të merren në apo me ujë apo ndonjë lëng tjetër të përshtatshëm.

Tretësirë orale	Përgatësat në formë tretësisë janë të parapara që të gëlltiten psh tretësirat orale, suspensionet, emulzionet apo pikat orale, duke përfshirë edhe ato të cilat përgatiten nga granulat apo pluhurat duke përjashtuar ato që janë për administrim promukozal psh gargarat dhe tretësirat për shpërlarje të gojës. Tretësirat orale të cilat janë në formë të pluhurit apo granulat japin një përparësi për shkak të stabilitetit dhe kostos më të lirë të transportit. Në rast se ka më shumë se një lloj të tretësirave orale në ët njëjtin treg (psh tretësira, suspensione, granula etj) ato mund të zëvendësohet dhe në ato raste ato duhet të jenë bioekuivalente. Preferohet që tretësirat orale të mos përmbajnë sheqer dhe që tretësirat për fëmijë të mos përmbajnë alkool.
-----------------	--

#### B. Administrimi parenteral

Injeksion	I referohet solucioneve, suspensioneve apo emulzioneve duke përfshirë edhe ato të cilat duhet të përfitohen me tretje të pluhurave apo tretësirave të koncentruara.
Injeksion (me kualifikim)	Rruga e administrimit mund të përfshihet në kllapa kur ka rëndësi
Infuzion intravenoz	I referohet tretësirave apo emulzioneve duke përfshirë ato të cilat përfitohen me tretje të pluhurave apo tretësirave të koncentruara.

#### C. Format tjera të dozimit

për sy	pika për sy, pomadë për sy
topikale	losione, tretësira, krema, pomada
rektale	supozitore, gel apo tretësirë
vagjinale	ovula apo tableta vagjinale
inhalim	pluhur për inhalim, inhalim i presuar, nebulizator

*Shënim - emrat e barnave janë të shënuara sipas emrit të pambrojtur ndërkombëtar ATC kodet janë orientues dhe disa produkte mund të kenë edhe ATC kode tjera varësisht nga forma farmaceutike dhe fortësia		ATC
<b>1. ANESTETIKET, BARNAT PREOPERATIVE DHE GAZET MEDICINALE</b>		
<b>1.1 Anestezia e përgjithshme dhe oksigjeni</b>		
<b>1.1.1 Barnat inhalatore</b>		
sevoflurane*	Tretësirë 250 ml *Furnizimet të kenë edhe pajisje (adapter) për kyçe në vaporizer	N01AB08
nitrous oxide	Inhalim.	N01AX13
oxygen	Inhalim (gaz medicinal)	V03AN01
<b>1.1.2 Barnat e injektueshme</b>		
ketamine	Injeksion: 50 mg (si hidroklorur) / ml, in 10- ml. flakon.	N01AX03
propofol*	Injeksion: 10 mg/ ml.; * Tiopentali 500 mg mund të përdoret si alternative varësisht nga kostoja dhe autorizimi për marketing	N01AX10
etomidate	Injeksion: 2mg/ml, 10ml	N01AX07
<b>1.2 Anesteziket lokal</b>		
o bupivacaine	Injeksion: 0.25%, 0.5% (hidroklorur) në flakon apo ampullë. Injeksion: për anestezë spinale: 0.5% (hidroklorur) në ampullë 4- ml. të tretet me 7.5% tretësirë glukozë	N01BB01
o lidocaine	Injeksion: 1%; 2% (hidroklorur) në flakon. Injeksion: për anestezë spinale: 0.5% (hidroklorur) / 2- ml. të tretet me 7.5% tretësirë glukozë. Format topikale: 2% to 4% (hidroklorur).	N01BB02 D04AB01
lidocaine - epinephrine (adrenaline)	Kartridzha dentar: 2% (hidroklorur) + epinephrine 1:80 000. Injeksion: 1%; 2% (hidroklorur apo sulfat) + epinephrine 1:200 000 në flakon.	N01BB52
ropivacaine	Injeksion: 2mg/ml, 10ml dhe 5 mg/ml; 10ml epidural	N01BB09
ephedrine	Injeksion: 30 mg (hidroklorur) / ml. në 1- ml. (për përdorim gjatë anestezisë spinale gjatë lindjes, për të parandaluar hipotensionin)	C01CA26
<b>1.3 Barnat preoperative dhe sedative për procedura të shkurta</b>		
atropine	Injeksion: 1 mg (sulfat) në 1- ml.	A03BA01
o midazolam	Injeksion: 1 mg/ ml.; 2 ml dhe 5 ml Tretësirë orale: 2 mg/ ml. [c] Tableta: 7.5 mg, 15 mg.	N05C108
morfinë	Injeksion: 10 mg (sulfat apo hidroklorur) në 1- ml.	N02AA01
<b>1.4 Gazet Medicinale</b>		
oxygen	Inhalim - Për përdorim në menaxhimin e hipoksisë. *Jo më shumë se 30% oksigjen të neonatit më pak apo baraz me 32 javë gestative	V03AN01
<b>2. BARNAT PËR DHËMBJE DHE KUJDES PALLIATIV</b>		
<b>2.1 Barnat antiinflatore josteroidale dhe jo-opioide</b>		
acetylsalicylic acid	Supozitore: 50 mg deri 150 mg. Tableta: 100 mg dhe 500 mg.	B01AC06
ibuprofen a	Tretësirë orale: 200 mg/5 ml. Tableta: 200 mg; 400 mg; 600 mg. a Jo të fëmijet më të vegjël se 3 muajsh	M01AE01
paracetamol*	Tretësirë orale: 120 mg - 150 mg/5 ml.; Supozitore: 80 - 150 mg. Tableta: 100 mg, 500 mg. Injeksion: 500 mg, 1g * Nuk rekomandohet për përdorim antiinflatator për shkak se nuk është dëshmuar benefiti për atë efekt.	N02BE01
diclofenac	Injeksion: 25mg/ml, 3ml	M01AB05
metamizol	Injeksion: 1g/2ml	N02BB02
<b>2.2 Analgjeziket opioid</b>		
fentanyl*	Fllaster transdermal: 12 mcg/hr; 25 mcg/hr; 50 mcg/hr; 75 mcg/hr; 100 mcg/hr *për menaxhimin e dhëmbjeve kancerogje Injeksion: 50mcg/ml, 2ml Tableta: 300mcg sublingual	N02AB03 N01AH01 N02AB03
o morfina*	Granula (lirim i ngadalësuar, të tretet me ujë): 20 mg -200 mg (sulfat morfine) Injeksion: 10 mg (hidroklorur morfine apo sulfat morfine) në ampullë 1- ml. Tretësirë orale: 10 mg (hidroklorur morfine apo sulfat morfine)/5 ml. Tableta: (lirim i ngadalësuar): 10 mg- 200 mg (hidroklorur morfine apo sulfat morfine) Tableta: (lirim i menjëhershëm): 10 mg (sulfat morfine) * Alternativat kuftohen në hidromorfon dhe oksikodon.	N02AA01

oxycodone	Tableta: 5 mg	N02AA05
tramadol	Injeksion: 50 mg/mg, 2ml	N02AX02
methadone*	Tableta: 5 mg; 10 mg (si hidroklorur)	N07BC02
	Tretësirë orale: 5 mg/5 ml.; 10 mg/5 ml. (hidroklorur).	
	Koncentrat për tretësirë orale: 5 mg/ ml.; 10 mg/ ml. (hidroklorur).	
	* Për menaxhimin e dhembjes kanceroze	
<b>2.3 Barnat për simptoma tjera të zakonshme dhe kujdes palliativ</b>		
dexamethasone	Injeksion: 4 mg/ ml. në ampulla 1 ml. (si kripë dinatrium fosfat).	H02AB02
	Tretësirë orale: 2 mg/5 ml.	A01AC02
	Tableta: 2 mg [c]; 4 mg.	H02AB02
diazepam	Injeksion: 5 mg/ ml.	N05BA01
	Tretësirë orale: 2 mg/5 ml.	
	Tretësirë rektale: 2.5 mg; 5 mg; 10 mg.	
	Tableta: 5 mg; 10 mg.	
hyoscine butylbromide	Injeksion: 20 mg/ ml.	A03HB01
lactulose [c]	Tretësirë orale: 3.1-3.7 g/5 ml.	A06AD11
loperamide	Format e forta të dozimit oral: 2 mg	A07DA03
<b>3. ANTIALERGIKËT DHE BARNAT TJERA QË PËRDOREN NË ANAFILAKSË</b>		
dexamethasone	Injeksion: 4 mg/ ml. në ampulla 1 ml. (kripë dinatrium fosfat).	H02AB02
epinephrine (adrenaline)	Injeksion: 1 mg (si hidroklorur apo hidrogjen tartrate) në ampulla 1 ml.	C01CA24
hydrocortisone	Injeksion: 100 mg (si sakinat natriumi) në flakon.	H02AB09
c loratadine *	Tretësirë orale: 1 mg/ ml.	R06AX13
	Tableta: 10 mg.	
	*mund të ketë edhe rol sedativ antihistaminik për disa indikacione të kufizuara (EMC)	
c prednisolone	Tretësirë orale: 5 mg/ ml. [c] Tableta: 5 mg; 25 mg.	H02AB06
chloropyramine	Injeksion: 10mg/ml, 2ml	R06AC03
noradrenaline	Injeksion: 2mg/ml, 1ml i.v dhe 1mg/ml,10ml	C01CA03
<b>4. ANTIDOTËT DHE SUBSTANCAT TJERA QË PËRDOREN TE HELMIMET</b>		
acetylcysteine	Injeksion: 200 mg/ ml. në 10- ml. ampulle.	R05CB01
	Tretësirë orale: 10% [c]; 20% [c].	
atropine	Injeksion: 1 mg (sulfat) në ampulla 1- ml.	A03BA01
calcium gluconate	Injeksion: 100 mg/ ml. në 10- ml. ampulla.	A12AA03
naloxone	Injeksion: 400 mcg (hidroklorur) në ampulla 1- ml.	A06AH04
pralidoxim	Injeksion: 1g, 10ml i.v	V03AB04
flumazenil	Injeksion: 0.1mg/ml, 5ml	V03AB25
<b>5. ANTIKOVULZANTET/ANTIPILEPTIKET</b>		
carbamazepine	Tretësirë orale: 100 mg/5 ml.	N03AF01
	Tableta: 200 mg. dhe 400 mg	
diazepam	Gel apo Tretësirë rektale: 5 mg/ ml. në tuba 0.5 ml.; 2- ml.; 4- ml.	N05BA01
c lorazepam	Formulim parenteral: 2 mg/ ml. në ampulla 1 ml. ; 4 mg/ ml. në ampulla 1 ml.	N05BA06
magnesium sulfate*	Injeksion: 0.5g/ ml. në ampulla 2- ml. (ekuivalent me 1 g në 2 ml.; 50% peshë/vëllim).	A06AD04
	0.5g/ ml. në 10- ml. ampulla (ekuivalent to 5 g in 10 ml.; 50% peshë/vëllim).	
	* Për përdorim në eklampsi apo pre-eklampsi të rëndë dhe jo për çrregullime tjera me konvulzione.	
phenobarbital	Injeksion: 200 mg/ ml. (natrium).	N03AA02
	Tretësirë orale: 15 mg/5 ml.	
	Tableta: 15 mg dhe 100 mg.	
phenytoin	Injeksion: 50 mg/ ml. in 5- ml. flakon (natrium).	N03AH02
	Tretësirë orale: 25 mg - 30 mg/5 ml.*	
	Format e forta orale: 25 mg; 50 mg; 100 mg (natrium).	
	Tableta (përtpëse): 50 mg. * Prezenca e të dy fortësive 25 mg/5 ml. dhe 30 mg/5 ml. mund të shkaktojë konfuzion në përkrah dhe dispensim prandaj duhet të shruarjet.	
valproic acid (natrium valproate)	Tretësirë orale: 50 mg/ml.; 200mg/5ml	N03AG01
	Pika: 300mg/ml	
	Tableta: (të mbeshjtella): 300 mg; 500 mg (natrium valproate).	
levetiracetam	Tableta: 250mg, 750mg, 500mg, 1g.	N03AX14
Pyridostigmine	Tableta: 60 mg.	N07AA02
<b>6. BARNAT ANTIINFEKTIVE</b>		
<b>6.1 Anthelmintikët</b>		



<b>6.1.1 Anthelmintikët intestinal</b>			
Mebendazole	Tableta: (përtypëse): 100 mg; 500 mg.		P02CA01
<b>6.2 Antibakterikët</b>			
Për të ndihmuar në programin e kujdestarisë së antibiotikëve në nivelin lokal, nacional dhe atë global si dhe për të ulur shkallën e rezistencës antimikrobike. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përgatitur klasifikimin e antibiotikëve në kategorinë AWaRe. Kjo është shkurtës e fjalëve ACCESS (Qasje), WATCH (mbikqyrje/përcjellje) dhe RESERVE (rezervë) dhe nënkupton klasifikimin e antibiotikëve në grupe të ndryshme për të theksuar rëndësinë e përdorimit korrekt të tyre në trajtimin e infeksioneve të ndryshme.			
<b>Grupi 1 - ANTIBIOTIKËT E GRUPIT ACCESS (TË QASSHËM)</b>			
Ky grup përfshin antibiotikët, të cilët kanë aktivitet kundër një numri të madh të mikrobeve të ndryshme patogjene, të cilat tregojnë potencial më të ulët të rezistencës sesa antibiotikët në grupet e tjera. Disa antibiotikë të këtij grupi rekomandohen si opsioni kryesor i parë ose i dytë në terapinë empirike për infeksionet e ndryshme. Antibiotikët e këtij grupi janë thelbësorë dhe popullata duhet të ketë qasje të plotë në to, të jenë të përballueshëm dhe të kenë cilësi të siguruar. Lista e këtyre antibiotikëve është dhënë në vijim. Disa antibiotikë të grupit ACCESS, po ashtu mund të përfshihen edhe në grupin e dytë WATCH.			
<b>ANTIBIOTIKËT E GRUPIT ACCESS SIPAS LISTËS SË OBSH-së TË VITIT 2019</b>			
Amikacin	Benzylpenicillin	Cloxacillin	Phenoxymethylpenicillin
Amoxicillin	Cefalexin	Doxycycline	Procaine benzylpenicillin
Amoxicillin + clavulanic acid	Cefazolin	Gentamicin	Spectinomycin
Ampicillin	Chloramphenicol	Metronidazole	Sulfamethoxazole + trimethoprim
Benzathine benzylpenicillin	Clindamycin	Nitrofurantoin	
Komiteti i Ekspertëve të OBSH ka miratuar target indikatorin, i cili bazohet në qasjen AWaRe dhe specifikon se së paku 60% e konsumit të antibiotikëve në një shtet duhet t'i takojë grupit ACCESS. Sipas publikimeve të fundit të OBSH-së, Kosova ka përdorur 56.2% të antibiotikëve nga grupi ACCESS.			
<b>GRUPI 2 - ANTIBIOTIKËT E GRUPIT WATCH (mbikqyrje/përcjellje)</b>			
Ky grup përfshin klasët e antibiotikëve që kanë potencial më të lartë të shfaqjes së rezistencës dhe përfshin shumicën e agjentëve me prioritet të lartë në mesin e Antimikrobikëve me rëndësi kritike për injektimin humanë dhe / ose antibiotikët që kanë rrezik relativisht të lartë të shkaktojnë rezistencë bakteriale. Këto barna duhet të kenë prioritet si objektiva kryesorë të programeve të monitorimit dhe kujdestarisë së antibiotikëve. Disa antibiotikë të grupit Watch rekomandohen si opsioni kryesor i parë ose i dytë në terapinë empirike për një numër të kufizuar të infeksioneve dhe ato janë dhënë në listën e mëposhme ( <a href="http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/251715/1/9789241511469-eng.pdf?ua=1">http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/251715/1/9789241511469-eng.pdf?ua=1</a> )			
<b>ANTIBIOTIKËT E GRUPIT WATCH SIPAS LISTËS SË OBSH-së SË VITIT 2019</b>			
Azithromycin	Ciprofloxacin		
Cefixime	Clarithromycin		
Cefotaxime	Meropenem		
Ceftazidime	Piperacillin + tazobactam		
Ceftriaxone	Vancomycin		
Cefuroxime			
1 <a href="http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/251715/1/9789241511469-eng.pdf?ua=1">http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/251715/1/9789241511469-eng.pdf?ua=1</a>			
<b>Grupi 3- ANTIBIOTIKËT E GRUPIT REZERVË</b>			
Ky grup përfshin antibiotikë dhe klasë të antibiotikëve, të cilët duhet të rezervohen për trajtimin e infeksioneve të konfirmuara ose ato që dyshohet se janë shkaktuar nga mikroorganizmat multirezistentë ndaj terapisë. Antibiotikët e grupit rezervë duhet të konsiderohen si "opsioni i fundit" terapeutik. Disa prej antibiotikëve të grupit rezervë renditen si barna individuale nëpër Listën e barnave, kur ato kanë më shumë dobi sesa rrezik dhe aktivitet të dështuar kundër mikrobeve patogjene me "prioriteti kritik" ose "prioritet të lartë" të identifikuar nga Lista e Patogjenëve Prioritarë të OBSH-së, veçanërisht Enterobakteret rezistente ndaj karbapenemeve. Këto antibiotikë duhet të jenë të qasshëm, por përdorimi i tyre duhet të përshtatet për pacientët dhe institucionet shumë specifike, atëherë kur të gjitha alternativat e tjera kanë dështuar ose nuk janë të përshatshme për zbatimin. Këto barna mund të mbrohen dhe të përcaktohen me përparësi si synime kryesore të programeve të kujdestarisë së antibiotikëve që përfshijnë raportimin e monitorimit dhe përdorimit, me qëllim që të ruhet efektiviteti i tyre.			
<b>ANTIBIOTIKËT E GRUPIT REZERVË SIPAS LISTËS SË OBSH-së SË VITIT 2019</b>			
Ceftazidime + avibactam	Meropenem + vaborbactam		
Colistin	Plazomicin		
Fosfomycin (intravenoz)	Polymyxin B		
Linezolid			
<b>6.2.1 ANTIBIOTIKËT E GRUPIT ACCESS</b>			
Amikacin	Injeksion: 250 mg (si sulfat)/ml, në flakon 2- ml.		101GB06
	ZGJEDHJA E PARË: - pielonefriti ose prostatiti (i rëndë)	ZGJEDHJA E DYTË: - neutropenia febrile e rrezikut të lartë - sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]	
	Pluhur për tretësirë orale: 125 mg (si trihidrat)/5 mL; 250 mg (si trihidrat)/5 mL. [c].		
	Format e forta orale: 250 mg; 500 mg (si trihidrat).		
	Pluhur për Injeksion: 250 mg; 500 mg; 1 g (si natrium) në flakon.		
	ZGJEDHJA E PARË: - pneumonia e shtuar në komunitet (komunitare)- (me pasqyrë klinike mesatare deri të rëndë) - pneumonia komunitare (e rëndë) [c]	ZGJEDHJA E DYTË: - meningjiti akut bakterial	

amoxicillin	<ul style="list-style-type: none"> <li>- kequshqyeshmëria akute e rëndë dhe e ndërlikuar [c]</li> <li>- përkeqësimet e sëmundjeve kronike obstruktive të mushkërive (SKOM)</li> <li>- infeksionet e traktit të poshtëm urinar</li> <li>- otitis media</li> <li>- faringjiti</li> <li>- sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]</li> <li>- sinuziti</li> <li>- kequshqyeshmëria akute e rëndë dhe e pandërlikuar [c]</li> <li>- abscesi progresiv aplikal i dhëmbit</li> </ul>		J01CA04
amoxicillin + clavulanic acid	<b>Tretësirë orale:</b> 125 mg amoxicillin + 31.25 mg clavulanic acid/5 ml. DHE: 250 mg amoxicillin + 62.5 mg clavulanic acid/5 ml. [c]		J01CR02
	<b>Tableta: 500 mg (si trihidrat) + 125 mg (si kripë kaliumi).</b>		
	ZGJEDHJA E PARË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pneumonia komunitare (e rëndë) [c]</li> <li>- infeksionet e komplikuara intraabdominale (mesatare deri të rënda)</li> <li>- përkeqësimet e SKOM</li> <li>- pneumonia e ftoz në spital (pneumonia spitalore)</li> <li>- neutropenia febrile me rrezik të ulët</li> <li>- infeksionet e traktit të poshtëm urinar</li> <li>- sinuziti</li> <li>- infeksionet e lëkurës dhe të indeve të buta</li> </ul>	ZGJEDHJA E DYTË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Infeksionet e eshtrave dhe nyjave</li> <li>- pneumonia komunitare (mesatare)</li> <li>- pneumonia komunitare (e rëndë)</li> <li>- otitis media</li> <li>-infeksionet pas kafshimeve</li> <li>-profilaksa kirurgjike</li> </ul>	
ampicillin	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 500 mg; 1 g (si kripë natriumi) në flakon.		J01CA01
	ZGJEDHJA E PARË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pneumonia komunitare (e rëndë) [c]</li> <li>- kequshqyeshmëria akute e rëndë dhe e ndërlikuar [c]</li> <li>- sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]</li> </ul>	ZGJEDHJA E DYTË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- meningjiti akut bakterial</li> </ul>	
benzathine benzylpenicillin	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 900 mg benzylpenicillin (= 1.2 milion IU) në flakon 5- ml. [c]; 1.44 g benzylpenicillin (= 2.4 milion IU) në flakon 5- ml.		J01CE08
	ZGJEDHJA E PARË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- sifilisi</li> </ul>	ZGJEDHJA E DYTË: <ul style="list-style-type: none"> <li>---</li> </ul>	
benzylpenicillin	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 600 mg (= 1 milion IU); 3 g (= 5 milion IU) (kripë e natriumit ose kaliumit) në flakon.		J01CE01
	ZGJEDHJA E PARË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- pneumonia komunitare (e rëndë) [c]</li> <li>- kequshqyeshmëria akute e rëndë dhe e ndërlikuar [c]</li> <li>- sepsa tek të porsalindurit dhe tek fëmijët [c]</li> <li>- sifilisi</li> </ul>	ZGJEDHJA E DYTË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- meningjiti akut bakterial [c]</li> <li>-endokarditi</li> </ul>	
cefalexin	<b>Pluhur për tretje me ujë:</b> 125 mg/ 5 ml; 250 mg/5 ml (anhidroz)		J01DB04
	<b>Format orale të forta:</b> 250 mg (si monohidrat)		
	ZGJEDHJA E PARË: <ul style="list-style-type: none"> <li>---</li> </ul>	ZGJEDHJA E DYTË: <ul style="list-style-type: none"> <li>-përkeqësimet e SKOM</li> <li>-faringjiti</li> <li>-infeksionet e lëkurës dhe infive të buta</li> </ul>	
cefazolin* a	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 1 g (si kripë e natriumit) në flakon.		J01DB04
	a > 1 muaj.		
	ZGJEDHJA E PARË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- profilaksa kirurgjike</li> </ul>	ZGJEDHJA E DYTË: <ul style="list-style-type: none"> <li>- infeksionet e eshtrave dhe nyjave</li> </ul>	
chloramphenicol	Kapsula: 250 mg. Suspenszion vajor për injeksion* 0.5 g (si sukeinat natriumi)/ ml. në ampullë 2- ml. * Vetëm për trajtimin e meningjitit epidemik te fëmijët mbi 2 vjeç dhe te të triturit. <b>Tretësirë orale:</b> 150 mg (si palmitat) 5 ml. Pluhur për injeksion: 1 g në flakon.		J01BA01
	ZGJEDHJA E PARË	ZGJEDHJA E DYTË:	

clindamycin	<b>Kapsula:</b> 150 mg (si hidrokloruri)		J01FF01
	<b>Injeksion:</b> 150 mg (si fosfat) / ml.		
	<b>Tretësirë orale:</b> 75 mg/5 ml. (si palmitat) [c].		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
		- Infeksionet e eshtrave dhe nyjave - Infeksione të rënda me SGA, p.sh. fasciiti nekrotizues, sindromi i shokut toksik. - Infeksionet anaerobe, p.sh. sepsa intraabdominale, infeksione anaerobe bronkopulmonare. - Pneumonia nga P. jiroveci (në kombinim me primaquine). - Malaria P. falciparum (në kombinim me kininën).	
cloxacilin*	<b>Kapsula:</b> 500 mg; 1 g (si kripë e natriumit).		J01CF02
	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 500 mg (si kripë e natriumit) në flakon.		
	<b>Pluhur për tretësirë orale:</b> 125 mg (si kripë e natriumit)/5 ml.		
	*cloxacilin, dicloxacilin und flucloxacilin preferohen për përdorim oral për shkak të absorbimit më të mirë		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
	- infeksionet e eshtrave dhe nyjave - infeksionet e lëkurës dhe indeve të buta	- sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]	
doxycycline a	<b>Tretësirë orale:</b> 25 mg/5 ml. [c]; 50 mg/5 ml. (anhidroz) [c].		J01AA02
	<b>Format e forta orale:</b> 50 mg [c]; 100 mg (si hiçlat).		
	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 100 mg në flakon.		
	a përdorimi të fëmijët nën 8 vjeç vetëm nëse ka infeksion që kërcënon jetën dhe nuk ka alternativë tjetër terapeutike.		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
	- infeksionet seksualisht të transmetueshme nga Chlamydia trachomatis - kolera - Infeksione rriçeciale - ethet Q. - bruceleza - shtundra e llajmit	- kolera [c] - pneumonia komunitare (mesatare) - përkeqësimet e SKOM.	
gentamicin	<b>Injeksion:</b> 10 mg, 40 mg, 60 mg (si sulfat) / ml. në flakon 2- ml.		J01GB03
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
	- pneumonia komunitare (e rëndë) [c] - keqshqyeshmëria akute e rëndë dhe e ndërlikuar [c] - sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]	- gonorea - profilaksa kirurgjike	
metronidazole	<b>Injeksion:</b> 500 mg në flakon 100- ml. .		J01XD01
	<b>Tretësirë orale:</b> 200 mg (si benzoate)/5 ml.		
	<b>Supozitorë/vaginaleta:</b> 500 mg; 1 g.		
	<b>Tableta:</b> 200 mg to 500 mg.		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
	- infeksioni me C. difficile - infeksionet e komplikuara intraabdominale (mesatare) - infeksionet e komplikuara intraabdominale (të rënda) - trikomoniaza - gjiardiaza - profilaksa kirurgjike	- infeksionet e komplikuara intraabdominale (mesatare)	
nitrofurantoin	<b>Tretësirë orale:</b> 25 mg/5 ml. [c]		J01NE01
	<b>Tableta:</b> 100 mg		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
	- infeksionet e traktit të poshtëm urinar	---	
phenoxymethylpenicillin	<b>Pluhur për tretësirë orale:</b> 250 mg (si kripë kaliumi) /5 ml.		J01CE02
	<b>Tableta:</b> 250 mg (si kripë kaliumi).		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	
	- pneumonia komunitare (mesatare)	---	

	- faringjiti - abscesi progresiv apikal i dhëmbit - profilaksa e etheve reumatike		
procaine benzylpenicillin*	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 1 g (=1 million IU), 3 g (=3 million IU) në flakon.  * Procaine benzylpenicillin nuk rekomandohet si terapi e zgjedhjes së parë në sepsën neonatale, përveç institucioneve që kanë shkallë të lartë të vdekshmërisë së foshnjave.  ZGJEDHJA E PARË: - sifilisi [c]	ZGJEDHJA E DYTË: - sifilisi	J01CE09
sulfamethoxazole + trimethoprim*	<b>Injeksion:</b> 80 mg + 16 mg/ ml. në ampula 5- ml.; 80 mg + 16 mg/ ml. në ampula 10- ml. <b>Tretësirë orale:</b> 200 mg + 40 mg/5 ml.. <b>Tableta:</b> 100 mg + 20 mg; 400 mg + 80 mg; 800 mg + 160 mg.  * trimetoprime si agjens i vetëm mund të jetë alternativë e infeksioneve të traktit të poshtëm urinar.  ZGJEDHJA E PARË: - infeksionet e traktit të poshtëm urinar (nëse janë të ndjeshme dhe nuk ka mundësi të tjera) - Pneumonia nga Pneumocistis jiroveci (trajtimi dhe profilaksia);	ZGJEDHJA E DYTË:  - diarrea akute invazive / dizenteria bakteriale  - toksoplazmoza (profilaksia dhe terapi e linjës së dytë); - nokardioza (terapi e linjës së dytë)	J01EE01
<b>6.2.2. ANTIBIOTIKËT E GRUPIT WATCH</b>			
azithromycin*	<b>Kapsula:</b> 250 mg; 500 mg (anhidroze). <b>Tretësirë orale:</b> 200 mg/5 ml.  * po ashtu, përdoret si terapi njëdozëshe në trajtimin e traktit dhe sëmundjes tropikale "yaws".  ZGJEDHJA E PARË: - infeksionet seksualisht të transmetueshme me Chlamydia trachomatis - kolera [c] - gonorrea - etiet tifoide	ZGJEDHJA E DYTË:  - diarrea akute invazive bakteriale / dizenteria - gonorrea	J01FA10
cefixime	<b>Kapsula ose tablet:</b> 200 mg; 400 mg (si trihidrat) <b>Pluhur për tretësirë orale:</b> 100 mg/ 5 ml [c]  ZGJEDHJA E PARË: - Faringjiti, - Oriti, - infeksionet urinare - infeksionet respiratore	ZGJEDHJA E DYTË: - diarrea akute invazive bakteriale / dizenteria - gonorrea	J01DD08
cefotaxime*	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 250 mg për flakon (si kripë natriumi)  * cefalosporinë e zgjedhur e gjeneratës së tretë për përdorim tek të porsalindurit e hospitalizuar  ZGJEDHJA E PARË: - meningjiti akut bakterial - pneumonia komunitare (e rëndë) - infeksionet e ndërlikuara intraabdominale (mesatare) - infeksionet e ndërlikuara intraabdominale (të rënda) pneumonia spitalore - pielonefriti ose prostatiti (i rëndë)	ZGJEDHJA E DYTË: - infeksionet e eshtrave dhe nyjave - pielonefriti ose prostatiti (mesatar) - sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]	J01DD01
ceftriaxone* a	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 250 mg; 1 g (si kripë e natriumit) në flakon.  * të mos jepet me kalcium dhe të shmangët përdorimi të fëmijët me hiperbilirubinemi. a >41 javë të gestacionit.  ZGJEDHJA E PARË: - meningjiti akut bakterial - pneumonia komunitare (e rëndë) - infeksionet e ndërlikuara intraabdominale (mesatare) - infeksionet e ndërlikuara intraabdominale (të rënda) - pneumonia spitalore - gonorrea - pielonefriti ose prostatiti (i rëndë)	ZGJEDHJA E DYTË:  - diarrea akute invazive bakteriale / dizenteria - infeksionet e eshtrave dhe nyjave - pielonefriti ose prostatiti (mesatar) - sepsa tek të porsalindurit dhe fëmijët [c]	J01DD04

	- ethet tifoide		
cefuroxime	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 250 mg, 750 mg, 1.5 g në flakon (si kripë e natriumit)		
	ZGJEDHJA E PARË: ---	ZGJEDHJA E DYTË: -profilaksa kirurgjike	J01DC02
ciprofloxacim	<b>Tretësirë orale:</b> 250 mg/5 ml (anhidroze) [c]		
	<b>Tretësirë për infuzion IV:</b> 2 mg/ ml. (si hidrat) [c]		
	<b>Tableta:</b> 250 mg (si hidroklorur).		
	ZGJEDHJA E PARË: - diarrra akute invazive bakteriale / dizenteria - neutropenia febrile me rrezik të ulët - pielonefriti ose prostatiti (mesatar) - ethet enterike	ZGJEDHJA E DYTË: - kolera - infeksionet e komplikuara intraabdominale (mesatare)	J01MA02
clarithromycin**	<b>Format e forta orale:</b> 500 mg.		
	<b>Pluhur për tretësirë orale:</b> 125 mg/5 ml.; 250 mg/5 ml.		
	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 500 mg në flakon		
	*Eritromicina mund të jetë alternative		
	† klaritromicina po ashtu është e listuar për përdorim në regjimin të kombinuar për eradikimin e <i>H. pylori</i> tek të rriturit.		J01FA09
	ZGJEDHJA E PARË: - pneumonia komunitare (e rëndë) - pneumonitë atipike	ZGJEDHJA E DYTË: - faringjiti	
piperacilin + tazobactam	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 2 g (si kripë e natriumit) + 250 mg (si kripë e natriumit), 4 g (si kripë e natriumit) + 500 mg (si kripë e natriumit) në flakon		
	ZGJEDHJA E PARË: - infeksionet e ndërlikuara intraabdominale (të rënda) - neutropenia febrile me rrezik të lartë - pneumonia spitalore - infeksionet polimikrobike	ZGJEDHJA E DYTË: ---	J01CJ05
vancomycin	<b>Kapsula:</b> 125 mg, 250 mg (si hidroklorur)		
	<b>Injeksion:</b> 500 mg		
	ZGJEDHJA E PARË: ---	ZGJEDHJA E DYTË: - infeksionet me <i>C. difficile</i> - neutropenia febrile e rrezikut të lartë - Infeksionet e rënda të shkaktuara nga MRSA; - meningjiti nga <i>S. pneumoniae</i> rezistent ndaj penicilinës; - endofalmiti;  - infeksionet intra-vaskulare të lidhura me kateterin dhe infeksionet nga shanti i lëngut cerebrospinal	J01XA01
cefazozime	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 250 mg or 1 g (si pentahidrat) në flakon		J01DD02
meropenem* a	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 500 mg (si trihidrat), 1 g (si trihidrat) në flakon		
	a > 3 muaj		
	* imipenem - cilastatin është një alternative, përveç rasteve të meningjitit akut bakterial, ku preferohet meropenemi		
	ZGJEDHJA E PARË: ---	ZGJEDHJA E DYTË: - meningjiti akut bakterial tek të porsalindurit [c] - infeksionet e komplikuara intraabdominale (të rënda) - neutropenia febrile me rrezik të lartë - infeksionet obstetrike dhe gjinekologjike, - infeksionet e komplikuara të traktit urinar, - infeksionet e indeve të buta dhe të kockave - infeksionet polimikrobike	J01DH02
	<b>Granula për suspension</b> 250 mg/5ml, 100-150 ml		
	<b>Tretësirë për Injeksion:</b> 500 mg, 1 g		
	ZGJEDHJA E PARË:	ZGJEDHJA E DYTË:	

eritromicina	-pneumonia komunitare - pneumonia atipike (p.sh. Mycoplasma pneumoniae, Chlamydia pneumoniae, Legionella pneumophila), -pertussis -gastroenteritet nga Campylobacter	-terapia te pacientët alergjik ndaj penicilinës	J011A01
<b>6.2.3. Grupi Rezervë</b>			
Cefalosporinat e gjeneratës së pestë (me ose pa inhibitor të beta-laktamazës) p.sh. ceftaroline		<b>Pluhur për Injeksion:</b> 400 mg, 600 mg (si fosamit) në flakon	
Cefalosporinat e gjeneratës së katërt (me ose pa inhibitor të beta-laktamazës) p.sh. cefepime		<b>Pluhur për Injeksion:</b> 500 mg; 1 g, 2 g (si hidroklorur) në flakon	
Polimiksinat ( Kolistina)		<b>Pluhur për Injeksion:</b> 1 milion I.U. (si kolistemetat natrium) në flakon	J01XB01
<b>6.2.4 Barnat antileprotike</b>			
dapsone	<b>Tableta:</b> 25 mg; 50 mg; 100 mg.		J04BA02
<b>6.2.5 Barnat antituberkulare</b>			
ethambutol	<b>Tretësirë orale:</b> 25 mg/ ml. [c]. <b>Tableta:</b> 100 mg to 400 mg (hidroklorur).		J04AK02
isoniazid	<b>Tretësirë orale:</b> 50 mg/5 ml. [c]. <b>Tableta:</b> 100 mg to 300 mg. <b>Tableta: (ndarëse):</b> 50 mg.		J04AC01
rifampicine	<b>Tableta:</b> 150 mg		J04AH02
isoniazid - rifampicin	<b>Tableta:</b> 75 mg + 150 mg; 150 mg + 300 mg. 60 mg + 60 mg (Për përdorim të herë pas hershëm 3 herë në javë). 150 mg + 150 mg (Për përdorim të herë pas hershëm 3 herë në javë). <b>Tableta: (disperzibile):</b> 50 mg + 75 mg [c]		J04AM02
pyrazinamide	<b>Tretësirë orale:</b> 30 mg/ ml. [c]. <b>Tableta:</b> 400 mg. <b>Tableta: (dispersibile):</b> 150 mg. <b>Tableta: (ndarëse):</b> 150 mg.		J04AK01
capreomycin	<b>Injeksion:</b> 1 g (si sulfat) në flakon.		J04AB30
cyclo-serine*	<b>Format e fortu orale:</b> 250 mg. *Terizidone mund të jetë një alternativë.		J04AB01
ethionamide*	<b>Tableta:</b> 125 mg; 250 mg. *Protionamide mund të jetë një alternativë.		J04AD03
levofloxacin	<b>Tableta:</b> 250mg; 500 mg; 750 mg.		J01MA12
p-aminosalicylic acid	<b>Granula:</b> 4 g në qeska. <b>Tableta:</b> 500 mg.		J04AA01
streptomycin [c]	<b>Pluhur për Injeksion:</b> 1 g (si sulfat) në flakon.		J01GA01
